

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI

Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA

Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7357 E shtunë 18 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga ILIR META

Arti është një element thelbësor i jetës politike dhe shoqërore në demokraci dhe mjediset kulturore paraqesin hapësira, ku kontaktet ndërkombëtare ...  
Vijon në faqen 11

Arti është politika më e mirë që bashkon kombet



Opinion

Ditës

Nga DELVINA KËRLUKU

Para ca muajsh bëra një shkrim, ku vura në spikamë neglizhencën apo veprimin e qëllimshëm të ambasadorit të BE-së në Shkup, z.Zhbogar, i cili në ...  
Vijon në faqen 12

Ç'është ky diskriminim që përsëritet e përsëritet?!



MINISTRIA E FINANCËVE, TRASHËGIMTARËT E KATEGORISE JOPËRËSORE QË MARRIN KESTIN E DYTE

## ISH-TE PERNDJEKURIT, LISTA ME 1200 EMRAT

Përfituesit duhet të dorëzojnë brenda muajit nëntor numrin e llogarisë bankare. Në rast se nuk është aktiv, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbapsht në buxhet



Dëshmia në prokurori e kushëririt "seksor"

### Iu gjetën 34 mln lekë në banesë, KLD pezullon gjyqtarin Shkëlqim Miri: S'kam faj

Përgjimet nga telefonatat e mesazhet, mori rryshfet nga familjarët e Gentian Dodës

Këshilli i Lartë i Drejtësisë pezulloi dje nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, Shkëlqim Mirin. Sipas njoftimit për median, nën drejtimin e Presidentit të Republikës, Ilir Meta, Këshilli i Lartë i Drejtësisë zhvilloi mbledhjen plenare, e cila nisi pezullimin nga ushtrimi i detyrës të gjyqtarit Sh.M., ...

Në faqen 4



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

Në faqen 18-22

HAKMARRJA

Pas vrasjes sulmohet me armë shtëpia e Elton Çiços në Tepelenë

Në faqen 8

DIPLOMACIA

Bushati mbledhë ambasadorët. PD ankohet: Rama na përjashtoi nga negociatat me BE

Në faqen 2-3

TRYEZA

Studentja e UT: Ngacimet seksuale në universitete nuk denoncohen

Në faqen 9

USHTARAKET

Flasin prindërit e komandove dezertues: Kishin probleme ekonomike, u nxituan

Në faqen 5

RREFEHET MODERATORJA ROZA LATHI: 'PRONARI' I JETËS SIME



Alketa Vejsiu: Projektet në Itali, çfarë më lidh me Paolo Bonolis

Suplement

Bulqizë/ Ngarja në shkollën e Shupenzës, mësuesit: Kishte shumë tym, si i nxorëm gjimnazistët

### Testohet kaldaja në shkollë, asfiksohen 60 nxënës

Policia: Shkak, oxhaku i mbyllur. MASR: Pezullohet mësimi, inspektim kaldajave

Nga ENVER DOÇI

Testimi për herë të parë i sistemit të ngrohjes me pelet për pak sa nuk ka shkakuar tragjedi në shkollën e mesme "Rifat Manjani" në Shupenzë të Bulqizës. 60 nxënës të moshave



16-18 vjeç janë asfiksuar nga çlirimimi i gazrave dhe tymi që është shkaktuar nga kaldaja. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se ngjarja e rëndë ka ndodhur paraditen e djeshme rreth orës 10:40. Menjëherë pas njoftimit se nxënësit e shkollës ...

Në faqen 7

# INTEGRIMI PERPLASJA

Përrjashtimi nga KSA, Berisha: Vendim antikombëtar, të damkoset narkoshteti

## PD: Rama na përjashtoi nga negociatat për integrimin

"Qeveria ka frikë nga e vërteta e kriminalizimit"

Valentina Madani

Partia Demokratike akuzoi dje kryeministrin Edi Rama për përjashtimin e opozitës nga Këshilli i Stabilizim Asocimit Shqipëri-BE. Sipas demokratëve, kjo ndodh për herë të parë pas një tradite 6-vjeçare dhe vjen si rezultat i frikës së qeverisë nga e vërteta e kriminalizimit. "Që në vitin 2011, qeveria e Partisë Demokratike krijoi precedentin pozitiv të përfshirjes së kryetarit të Komisionit parlamentar për Integrimin Europian, asokohe Ditmir Bushati, në takimet vjetore të Këshillit të Stabilizim Asocimit Shqipëri-Bashkim Europian. Ky precedent pozitiv, bazuar në mbështetjen konsensuale mazhorancë-opozitë të anëtarësimit të vendit në BE, u kthye në traditë deri më 14 nëntor 2017, kur qeveria 'Rama' u paraqit në Bruksel vetëm me përfaqësuesit e saj si Ditmir Bushati e të tjerë, por pa opozitën. Kryetarit të Komisionit parlamentar për Integrimin Europian, Genc Pollo, nuk iu dërgua ftesë. Ky veprim nuk është vetëm frikë nga e vërteta e kriminalizimit të shtetit, e cila nuk fshihet dot më as në Tiranë, as në Bruksel e as gjetu. Është edhe shenjë e degradimit politik të kësaj qeverie, e cila po rrënon çdo trashëgimi politike pozitive që ka gjetur, duke u kapur fort mbas karriges si imbytur pas fijos së barit", thuhet në deklaratën e PD-së. Pas njoftimit nga opozita se qeveria e ka përjashtuar nga bisedimet që po zhvillohen në Bruksel për integrimin e Shqipërisë në BE, reagoi edhe ish-kryeministri Sali Berisha. Në një postim në "Facebook", Berisha shkruan se Noriega po mbyll dyert e integrimit të Shqipërisë. "Mediat bëjnë të ditur se neo-blokmenit Edvin Kristaq Rama, me sojin tjetër të bllokmenëve kanë përjashtuar fshehtas, si kulime të vërtetë, opozitën për të marrë pjesë në punimet e Këshillit të Stabilizim Asocimit të Shqipërisë me BE, që mblihet në Bruksel për të diskutuar për procedimin e integrimit të Shqipërisë në BE. Me këtë akt primitiv, pinjollët e bllokmenëve mizorë dëshmojnë se me urretjen e tyre për opozitën, ata janë në gjendje të marrin çdo vendim antikombëtar. Ata dëshmojnë se kanë tmerr nga veprat e tyre



## Basha, zv.ministrit austriak: Qeveria, e paralizuar nga krimi

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, gjatë takimit dje me zëvendësministrin e Jashtëm të Austrisë, Michael Linhart, e konsideroi qeverinë tërësisht të paralizuar për shkak të situatës së krijuar në vend nga zbulimi i lidhjeve të saj me trafikun ndërkombëtar të drogës. Basha i tha Linhart se nga kultivimi i kanabisit në Shqipëri po kalohet tek trafikimi i heroinës dhe kokainës dhe pastrimi i parave në fusha të caktuara të ekonomisë si ndërtimi dhe projektet PPP. "Emigrimi rekord i shqiptarëve drejt vendeve të Bashkimit Europian është pasojë e zhgënjimit nga qeverisja, e cila përfaqësohet në çdo nivel me njerëz të inkriminuar dhe të korruptuar. Bashkimi Europian nuk mund ta injorojë këtë problematikë, pasi i rrezikohet kredibiliteti", - tha z.Basha. Sipas tij, shem-



bja e lidhjeve të krimin me politikën është urgjencë kombëtare për të ndaluar marshimin e krimin të organizuar në qeverisje dhe ekonominë e vendit dhe për të rikthyer legjitimitetin e qeverisjes. Partia Demokratike beson se realizimi i reformës zgjedhore, duke përfshirë sistemin elektronik të votimit, është një nga mënyrat për të dalë nga kriza dhe për të kthyer besimin tek njerëzit. Kreu i PD-së e

falënderoi zv.ministrin e Jashtëm, Linhart për mbështetjen e fuqishme të Austrisë dhe veçanërisht të kryeministrit Kurz, për integrimin europian të Ballkanit. Në gjysmën e dytë të vitit të ardhshëm, Austria do të marrë presidencën e Bashkimit Europian dhe zv.ministri i shprehu z.Basha mbështetjen e plotë të vendit të tij për zbatimin e reformave dhe arritjes së rezultateve konkrete.

li i Stabilizim Asocimit të Shqipërisë me BE është një akt tjetër, me të cilin neoblokmenët zhbejnë një standard të vendosur para 6 viteve dhe që është i domosdoshëm në procesin e integrimin europian. "Me këtë akt, ata tregojnë se jo integrimi i vendit, por lufta



## Kryemadhi, me kreun e NDI: Standarde përëndimore, për financimin e partive

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi takoi dje drejtorin e Institutit Demokratik Amerikan për Europën Qendrore dhe Lindore, Robert Benjamin. Në fokus të takimit mësohet të ketë qenë rikonfirmimi i bashkëpunimit mes LSI dhe NDI-së dhe situata e demokracisë në Shqipëri. Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, gjatë takimit të djeshëm shprehu vlerësimet për ndihmën e NDI në asistencën për hartimin e politikave bashkëkohore dhe ngritjen e kapaciteteve të LRI dhe LGI, si dhe investimin e tyre për rritjen e transparencës financiare të partive politike në vend. Robert Benjamin vlerësoi bashkëpunimin me LSI, duke theksuar standardet e transparencës së adoptuar nga LSI.



## Gjoshja: Stabilitet s'do të thotë të mbyllim sytë para realitetit

Ish-ministria e Integrimit dhe deputetja e LSI, Klajda Gjoshja ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët për Ballkanin Perëndimor në Sarajevë. Përmes një statusi në "Facebook", Gjoshja thotë se gjatë diskutimit ka theksuar se duhet të jemi të kujdesshëm kur luajmë kartën e stabilitetit në rajonin tonë. Sipas Gjoshës, stabilitet nuk do të thotë të mbyllim sytë para realitetit, por do të thotë të mëndje më e madhe. "Tryezë e rrumbullakët parlamentare mbi Ballkanin Perëndimor në Sarajevë, drejtuar nga Tanja Fajon dhe Knut Fleckenstein. Gjatë diskutimit ishte me rëndësi të theksoja se duhet të jemi të kujdesshëm kur luajmë kartën e stabilitetit në rajonin tonë. Stabilitet nuk do të thotë të mbyllim sytë para realitetit, por do të thotë të mëndje më e madhe në funksionimin e shtetit të drejtës, në konsolidimin e demokracisë, institucione funksionale dhe zgjedhje të lira e të ndershme", shprehet Gjoshja.

kundër opozitës është qëllimi i tyre me parësor: Duke dënuar me forcën më të madhe këtë vendim të Edvin Kristaq Ramës, të përjashtimit të opozitës nga Këshilli i Stabilizim Asocimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian, si një akt atavist dhe antiko-



Ministri i Jashtëm mbledh ambasadorët e Shqipërisë, takim me ministrat e rajonit

# Bushati: Diplomaci ekonomike, jo vetëm telegrame e nota verbale

Shqipëri-Kroaci-Mali i Zi, avancim i Korridorit Adriatiko-Jonian

Darina Tanushi

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtë, Ditmir Bushati çeli dje punimet për takimin treditror me ambasadorët e RSH-së në botë "Ridimensionimi i Diplomacisë Ekonomike Shqiptare: Sfida dhe Mundësi". Në fjalën e tij, ministri Bushati vuri në pah nevojën e diplomacisë ekonomike në funksion të mirëqenies dhe sigurisë qytetarëve. "Për këtë arsye - vijoi ai - shembulli më i mirë është Bashkimi Evropian, ku mirëqenia e bashkëpunimi mes vendeve në funksion të zhvillimit ekonomik ka siguruar jetëgjatësinë më të madhe të paqes e sigurisë në historinë e kontinentit tonë". Për ministrin Bushati, shërbimi diplomatik duhet të kapërcëjë veten dhe atë çfarë di të bëjë më mirë, si notat verbale, telegramet dhe komunikimin diplomatik e konsullor mes të ngjashmëve, e të përftojë aftësi të cilat u përgjigjen nevojave të realitetit ku jetojmë, të ndërlihur e të varur prej zhvillimeve jashtë nesh. Kreu i diplomacisë shqiptare vlerësoi se na duhet të integrojmë organikisht në punën tonë të përditshme një vizion të ri për misionin që na është ngarkuar. Bushati tha se Shqipëria nuk është më një vend i izoluar, por i ndërlihur me shumë se kurrë me fqinjët evropianë. Ndaj në këto kushte, kur edhe teknologjia është kthyer në mjetin kryesor të komunikimit, Bushati ka nënvizuar se qëllimi i diplomacisë duhet të jetë zhvillimi ekonomik. Ai e ka cilësuar si shumë të rëndësishme ndërthurjen mes politikës dhe ekonomisë, interesat për të cilën sipas tij duhet të burojnë nga vlerat. "Shqipëria ka shumë vlera që duhen ngritur nga ne. Ky zhvillim kërkoi një qasje krejt të re, me formula dhe skema efikase për promovimin e Shqipërisë aty ku nuk na njohin dhe aty ku na njohin për keq", ka shtuar Bushati. Ky takim do të vijojë përgjatë tri ditëve me pjesëmarrjen edhe të Presidentit të Republikës dhe kryeministrit.



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtë, Ditmir Bushati

**DEKLARATA**

Ministrat e Jashtëm të të tria vendeve vlerësuan në përfundim të këtij takimi nevojën për të zgjeruar platformën trespalëshe të bashkëpunimit edhe me përfaqësues të lartë dhe ekspertë në fushat me interes, në mënyrë që idetë dhe propozimet e paraqitura në trelateral të materializohen dhe përkthehen në iniciativa dhe veprime konkrete.

Jashtme të Malit të Zi, Srgan Darmanovic për takimin e dytë të Trelateralit të Adriatikut midis Shqipërisë, Kroacisë dhe Malit të Zi. Në një deklaratë të përbashkët pas takimit, ministrat riafirmuan rëndësinë e platformës strategjike të bashkëpunimit midis tri vendeve, si një mekanizëm të vlefshëm që kontribuon në

sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e Evropës Juglindore. Gjatë takimit trespalësh, ministrat e Shqipërisë, Kroacisë dhe Malit të Zi u fokusuan në bashkëpunimin dhe koordinimin e vendeve tona në fushën e sigurisë, si dhe iniciativave kombëtare dhe rajonale në infrastrukturë, energjetikë dhe turizëm. Një fokus i

veçantë iu kushtua ecurisë dhe ndërveprimit për avancimin e projekteve të rëndësi strategjike si Korridori Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi që do lidhë linjën Trans-Adriatike me Kroacinë nëpërmjet Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnje Hercegovinës, por edhe bashkëpunimit në fushën e turizmit dhe mjedisit.

## Integrimi



**JOHANNES HAHN**

Në konferencën e përbashkët për shtyp në Bruksel me shefien e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, Johannes Hahn tha për herë të parë se rajoni i Ballkanit mund t'i bashkohet bllokut evropian edhe më përpara nga sa pritet gjerësisht. Viti 2025, sipas zyrtarit të lartë evropian është një datë e prekshme anëtarësimi.

## Buxheti 2018, Petrit Vasili: Shënon fundin e kësaj qeverie

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili gjatë një bashkëbisedimi me gazetarët ka komentuar me tone të ashpër se pse është kundër buxhetit. Buxheti u miratua rreth orës 02:05 të mëngjesit të së premtes me 75 votat e mazhorancës në parlament. Duke komentuar votimin në parlament nga shumica qeverisëse të projektbuxhetit në Kuvend, Vasili ka theksuar: "Dje u shënuar armiqësia mes qeverisë dhe pasanikëve të mëdhenj klientë të saj dhe familjes shqiptare, e cila mori shuplakë shumë të rëndë, shoqëruar me depresionin e madh të mungesës së shpresës". Sipas Vasilit, kjo shënon edhe "fundin e qeverisjes për një arsye shumë të thjeshtë, kur të paraqitet buxheti i radhës i 2019, qeveria nuk do arrijë ta paraqesë, nuk ka nevojë për kryeministër, secili mund të pajtonet financiar të zotit, pasi do shpërndante paratë e koncesioneve. Qeveria ka humbur dje mundësitë politike për prioritetet, strategjitë, rrugën ku do ecë vendi, nuk ka më para, po i shpërndan ato të secili prej pasanikëve të mëdhenj klientë dhe kjo e kthen qeverinë në institucion që u lan borxhet pasanikëve dhe u heq të drejtën familjeve për të vazhduar jetën. Praktikisht ne nuk kemi më nevojë për kryeministër. Dhe kryeministri ka shumë të drejtë që bën vetëm humor, ka atë pozicionin e tij të gaztorit të shpëlarë. Si çdo zanat që nuk di ta bëjë, qoftë atë të kryeministrit, atë të piktorit u provua nga kritika e huaj që as atë nuk di ta bëjë, qeveritarin nuk e ka bërë ndonjëherë", tha Vasili.



## Ambasadorja e BE-së, me vendorët: Do ju ndihmojmë të ndryshoni Vlahutin: Shqipëria duhet të plotësojë disa standarde para se të hyjë në BE

Ambasadorja e BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin deklaroi dje në një takim me 61 koordinatorët vendorë të BE-së për secilën bashki se ndryshimi që shqiptarët presin të ndodhë duhet të vijë para dhe jo pas anëtarësimit në Union. Në një prononcim për mediat pas një eventit të zhvilluar dje, Vlahutin ka ritheksuar se Bashkimi Evropian ka shumë standarde që Shqipëria duhet t'i plotësojë. "Bashkimi Evropian ua ndryshon jetën përditë, por kjo nuk mund të ndodhë në kohën kur Shqipëria të futet në BE, por përpara. Ndaj, kontributi ynë shkon për përmirësimin e sektorëve të caktuar. Shqipëria është në një moment të rëndësishëm", ka thënë Vlahutin. Projekti i financuar nga BE-ja "Bashkitë për në Evropë" zhvilloi dje në Qendrën e Informimit të BE-së në Tiranë një ditë pune për rrjetëzimin me 61 koordinatorët vendorë të BE-së, që janë vendosur në secilën bashki të vendit kandidat. Duke i drejtuar seminarin, kreu i delegacionit të BE, Romana Vlahutin, kujtoi se asgjë nuk do të ndryshojë për Shqipërinë ditën kur vendi do të bashkohet me BE-në, pasi gjithçka do të ketë ndryshuar tashmë më parë. "Unë besoj se qeverisja vendore, duke qenë më afër nevojave dhe dëshirave reale të qytetarëve, është vendi ku ndodhin ndryshimet e vërteta. Dhe këtë projekt ne do t'ju ndihmojmë të jeni pjesë e ndryshimit", u tha ambasadorja e BE-së, pjesëmarrësve nga e gjithë Shqipëria.



Ambasadorja e BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin, dje në një takim me 61 koordinatorët vendorë të BE-së

Vetingu në polici/ Ministri i Brendshëm, takim me drejtues të policisë

Khafaj në Elbasan, dy orët e informimit për rezultatet e luftës kundër krimit

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, zhvilloi dje një takim me strukturat drejtuese të Policisë së Elbasanit prej afro dy orësh. Takimi vjen në një kohë kur pak kohë më parë ministri i Brendshëm "shkriu" kupolën drejtuese të policisë së Elbasanit. Ministri i Brendshëm ka komunikuar me drejtuesit e komanduar rreth situatës aktuale të rendit dhe sigurisë publike në qytetin dhe Qarkun e Elbasanit. Ai ka inkurajuar policinë e Elbasanit për të rritur përkushtimin e tyre në

**MINISTRI**

Xhafaj ka paralajmëruar veting të plotë të trupës policore fillimisht në Elbasan dhe së shpejti në të gjitha drejtoritë vendore. Elbasani pas reformimit të plotë që do i nënshtrohet drejtoria vendore, pritet të kthejë besimin tek qytetarët duke garantuar rend dhe qetësi dhe luftë të pamëshirshme ndaj të gjitha figurave të krimit.

luftën ndaj krimit, i cili vitet e fundit në Elbasan ka tronditur jo rrallë rendin dhe sigurinë. Xhafaj ka paralajmëruar veting të plotë të trupës policore fillimisht në

Elbasan dhe së shpejti në të gjitha drejtoritë vendore. Elbasani pas reformimit të plotë që do i nënshtrohet drejtoria vendore, pritet të kthejë besimin tek qytetarët duke

garantuar rend dhe qetësi dhe luftë të pamëshirshme ndaj të gjitha figurave të krimit. Po kështu, ministri ka paralajmëruar përjashtimin nga radhët e policisë të punonjësve të lidhur me krimin si dhe zbulimin e krimeve të kryera në këtë qytet gjatë viteve të fundit. Takimi u zhvillua për të parë nga afër procesin e ristrukturimit të strukturave të kësaj drejtorie, ku është komanduar drejtues Altin Qato. Takimi në Policinë e Elbasanit u



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

bë edhe sepse në këtë drejtori do të implementohet një projekt pilot në 2018-ën për policimin në komunitet dhe kontrollin e territorit. Min-

istri Xhafaj në takimin me drejtuesit e Policisë Elbasan është informuar edhe për rezultatet në luftën kundër krimit të organizuar.

Dëshmia te Krimet e Rënda, kushëriri "seksër": Akuzat, të pabaza

**Iu gjetën 34 mln lekë në banesë, KLD pezullon gjyqtarin Shkëlqim Miri**

*Përgjimet, Miri mori rryshfet nga familjarët e Gentian Dodës*

Këshilli i Lartë i Drejtësisë pezulloi dje nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, Shkëlqim Miri. Sipas njoftimit për median, nën drejtimin e Presidentit të Republikës, Ilir Meta, Këshilli i Lartë i Drejtësisë zhvilloi mbledhjen plenare, e cila nisi pezullimin nga ushtrimi i detyrës të gjyqtarit Sh.M., pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dhënies së masës së sigurimit personal ndaj tij "Arrest në burg", me vendimin nr. 417 datë 12.11.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Gjyqtarit Shkëlqim Miri iu gjetën 300 milionë lekë në shtëpi dhe dyshohet se ai ka marrë 20 mijë euro për ndryshimin e një akuze. Prokuroria e Përgjithshme e honte Mirin prej gati një viti, me dyshimet se ishte korruptuar nga Gentian Doda. Hetuesit dyshonin se Doda pagoi 20 mijë euro për gjykatësin në këmbim lirisë. Gjykatësi ndryshoi kualifikimin e vrasjes së ndodhur në Burrel, në vitin 1997.

**DËSHMIA**

Ndërkohë dje në Prokurorinë e Krimeve të Rënda është thirrur Kujtim Mir, kushëriri i gjyqtarit, i dyshuar se bënte rolin e sekserit në këtë histori. Sipas burimeve, Kujtim Miri i ka mohuar akuzat e ngritura, duke thënë se ato janë të pabaza dhe nuk ka prova. Avokati mbrojtës i kushëritit të gjyqtarit është Ilir Murati. Ndërkohë sipas alibisë që ka ngritur në sallën e gjyqit,



Gjyqtari Shkëlqim Miri

**VENDIMET**

Bazuar në përcaktimet e rendit të ditës, KLD vendosi shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Elbasan, Q.H., për shkak të dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Në vijim Këshilli vendosi deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës të pensionit të dy magjistratëve.

gjykatësi i arrestuar për rryshfet, Shkëlqim Miri është i sëmurë dhe 300 milionë lekët që mbante në shtëpi i duheshin për t'u kuruar. Por në të njëjtën ditë që avokati i tij, Ardian Visha foli për mediat në lidhje me shumë e parave, prokurorët kanë nxjerrë provat e tyre. Përgjime telefonatash, mesazhe dhe pamje të kamerave të sigurisë pro-

vojnë sipas organit të akuzës se Shkëlqim Miri mori rryshfet nga familjarët e Gentian Dodës. I burgosuri mbante dy celularë në qelinë e tij, të dy në përgjim. Fillimisht ishte Gjykata e Matit, që firmosi për ndryshimin e akuzës për Dodën dhe i hapi rrugën e lirimit të tij. Në përgjim u vu i dënuari Doda, i cili në qelinë e tij mbante dy celu-

larë. Pas kontrollit të banesës, Miri iu gjetën dhe u sekuestruan 174.810 euro; 10,149,000 lekë dhe 1,000 dollarë.

**NGJARJA**

Gentian Doda u akuzua për vrasjen e Gazmir Dedjas mesditën e 27 tetorit të vitit 1997. Për këtë vrasje Doda u dënua 4 vite, më pas, më 26 janar 2001 me 20 vite burgim. Pesë muaj më pas Doda e apeloj vendimin, por Gjykata e Apelit i la në fuqi 20 vitet e burgut duke mospranuar ankimin e tij. Një vit më pas, 2 shkurt 2002 po e njëjta Gjykata e Apelit e Tiranës la në fuqi dënimin me 20 vite burg të dhënë nga shkalla e parë e gjykatës së Matit. Çështja e tij ndryshoi në 2012, kur Gentian Doda u ekstradua nga Amerika, ku u arrestua në Kaliforni për llogari të drejtësisë shqiptare. Ai iu drejtua Gjykatës së Lartë për t'i hequr dënimin, por kërkesa nuk u pranua. Ish-te Gjykata Kushtetuese që vendosi rihapjen e çështjes, pasi ishte dënuar në mungesë. Më 20 shtator 2016, Gjykata e Matit e dënoi përfundimisht Gentian Dodën me 8 vite burgim. Doda e apeloj këtë vendim sërisht dhe në qershor 2017 ai arrin që në Apelin e Tiranës, me vendim të gjyqtarëve Shkëlqim Miri, Flutura Skënderi dhe Agim Bendo të marrë ndryshimin e akuzës nga vrasje në plagosje duke fituar lirinë vetëm me kohën e paraburgimit të kaluar në qeli.

**ISH-MINISTRI**


Saimir Tahiri largohet jashtë vendit, prokuroria: Nuk i ndalohe

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri mësohet se ka luhduar jashtë vendit për arsye familjare. Referuar burimeve të "Balkanweb", ish-ministri nën hetim ka prerë një biletë vajtje-ardhje dhe sot në darkë pritet të mbërrijë në Rinas. Nga ana tjetër, gazetarja Klodiana Lala raportoi se burime nga Prokuroria e konfirmojnë që Tahiri ka dalë jashtë vendit, por burimet saktësojnë se nuk ka asnjë vendim gjykatë që e ndalon ish-ministrin të dalë jashtë kufijve dhe nuk ka akt ndalimi për pasaportën. Mësohet se Tahiri ka shkuar në Gjermani, ndërkohë që kjo lëvizje e tij ka ngjallur shumë debate, por burime nga prokuroria bëjnë të ditur se për sa kohë çdo masë u rrezua, edhe bllokimi i pasaportës ishte i pakuptimtë. Po sipas burimeve nga organi i akuzës, mësohet se për prokurorët e çështjes ishte shumë e nevojshme marrja e autorizimit për "arrest në burg", pasi rrezikoheshin provat. Po ashtu, ai duke qenë i lirë, ka mundësi të ndikojë për provat dhe dëshmitarët.

**MINISTRJA**

Emergjencat, Olta Xhaçka mbledh prefektët: Zyra juaj është terreni

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka në një takim me 12 prefektët e sapoemëruar në vend, kërkoi një planifikim të qartë masash për parandalimin dhe për menaxhimin e Emergjencave Civile. "Masat e marra gjatë emergjencave civile kanë impakt direkt në jetën e komunitetit. Për mangësitë e konstatuara në udhëzime apo akte të tjera, do vlerësoja maksimalisht kontributin tuaj të mirëkoordinuar, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e punës për çdo hallkë që është pjesë e Emergjencave Civile. Por në rastet e emergjencës, besoj se çdonjëri prej nesh do e kishte të vështirë të mbështetej tek mangësitë, për të evituar zgjidhjen e situatës. Pra, prioriteti ynë kryesor është garancia për komunitetin në çdo qytet, fshat, komunë, që ne jemi prezent me plane të koordinuar mirë dhe me kapacitetet e nevojshme që garantojnë zgjidhjen në raste emergjencash", tha ministria e Mbrojtjes. "Në raste emergjencash dhe ngjarjesh të jashtëzakonshme, zyra juaj duhet të jetë terreni, sikurse kompetenca juaj është ndjekja e planit të veprimit hap pas hapi", - iu drejtua ajo prefektëve të rinj. Ministria e Mbrojtjes kërkoi nga prefektët veprim të shpejtë dhe të zhdërvjellët sipas pikave të një plani të qartë veprimi, të konceptuar si një "Protokoll Tip Veprimesh" në situata të jashtëzakonshme.



**TIRANË** - Një ditë pas publikimit të lajmit për dezertimin e katër efektivëve të Forcave të Armatosura në Britaninë e Madhe, ka reaguuar dhe babai i komandos, Renild Ajazi. Bëhet fjalë për Xhelal Ajazin, i cili u shpreh për "Gazeta Shqiptare" se djali i tij i kish-tënë në telefon në datën 10 tetor për dezertimin dhe se ajo ka qenë telefonata e fundit.

## Telefonata e fundit me djalin komando, Xhelal Ajazi: Im bir ankohej shpesh për rrogën e ulët

Ndërkaq, Xhelal Ajazi pohoi se i biri i ankohej shpesh për pagën e ulët dhe se kjo mund të ketë qenë arsyeja e dezertimit. "Folëm në telefon në datë 10 tetor me djalin dhe kjo ka qenë telefonata e fundit me të. Renildi na tha se ishte mirë. Ai jetonte

me qira në Tiranë dhe se ishte hera e parë që dilte jashtë shtetit", tha i ati i komandos. Ndërkaq, ai u shpreh se ka qenë vetë pjesë e ushtrisë dhe se djali i tij ka bërë veprim të nxituar. "Kam qenë vetë pjesë e ushtrisë, djali ka bërë një veprim të nxituar",

deklaroi Ajazi. Ndërkaq, mësohet se katër ushtarakët nga Batalioni i Këmbësorisë në Zallhërr: Aleksandër Shkulaku, Ylber Tokli, Reni Id Ajazi dhe Klevis Lamkaj një ditë përpara largimit nga Uellsit kanë kërkuar leje për të dalë nga

baza Brecon për të vizituar qytetin e Kardifit. Mësohet se fotot e 4 ushtarakëve shqiptarë u janë shpërndarë të gjitha një-sive të policisë ushtarake në Britaninë e Madhe. Ministria e Mbrojtjes në një deklaratë për median deklaroi se, "Sipas Kodit Penal Ushtarak", ndaj 4 efektivëve, pranë Prokurorisë së Rrethit, Tiranë është depozituar kallëzim penal "Për dezertim".



**Dosja "Lazarati", prokuroria kërkon 57 vite burg për grupin e Gates**

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka mbyllur dje hetimet për dosjen "Lazarati 2014" dhe ka lexuar pretendencën me vitet e dënimit që ka kërkuar për secilin prej të dënuarve, të njohur si grupi i zjarrit. Prokuroria ka kërkuar 57 vite burg për pesë të pandehurit Arbjon Aliko, Gurgaz Skënderi, Alfred Proko, Enrik Skënderin dhe Beqo Brahimajn. Organi i akuzës në pretendencë kërkoj 14 vite burg për Arbjon Alikon, 13 vite burg për Gurgaz Skënderin, 11 vite burg për Enrik Skënderin, 11 vite burg për Alfred Prokon dhe 8 vite për Beqo Brahimajn. Pesë të pandehurit janë pjesë e grupit të Gate Mahmutajt, por procesi ndaj tyre ka vijuar i pavarur nga ai i kreut të grupit. Gate Mahmutaj akuzohet edhe për vrasjen e efektivit të RENEA në vitin 2015, Ibrahim Basha.

Ina Allkanjari

# Babai i komandos që dezertoi në Angli: djali ka probleme ekonomike

## Lulzim Shkulaku: U nxitua, të kthehet në Shqipëri

Pas dezertimit të katër komandove shqiptarë, të cilët po kryenin trajnim ushtarak në një bazë në Angli, ka reaguuar babai i njërit prej tyre. Lulzim Shkulaku, i ati i Aleksandrit, të riut nga Pogradeci, i ka bërë thirrje të birit të kthehet në atdhe. Katër ushtarët Reni Ajazi, Ylber Tokri, Aleksandër Shkulaku dhe Klevis Lamkaj pasi kanë kryer detyrën e tyre jashtë vendit, nuk janë kthyer në Shqipëri duke vendosur të emigrojnë në Britaninë e Madhe. Ata akuzohen për "Mosparaqitje në repart" ose dezertim. Mësohet se hetimet kanë nisur nga seksioni ushtarak në prokurorinë e kryeqytetit, e cila u ka dërguar homologëve në Britani urdhërndalimi për komandot. Nga hetimet paraprake mendohet se katër ushtarakët kanë shkuar tek një i afërm që ka biznes në Londër për t'u punësuar aty, i cili dyshohet të jetë edhe personi që i ka shoqëruar për t'u larguar nga baza ku qëndronin. Sipas prokurorisë, nga fillimi i tetorit deri në mesin e nëntorit 2017 janë depozituar nga Policia Ushtarake 16 kallëzime penale për efektivë të ushtrisë që kanë vendosur të thyjnë betimin dhe të mos paraqiten në repart. Në lidhje me këtë ngjarje kanë reaguuar edhe mediat e huaja, "Daily Mail" dhe "Associated Press", të cilat shkruajnë se Ministria shqiptare e Mbrojtjes ka ngritur akuza për katër oficerët, të cilët nuk janë rikthyer më në Shqipëri pas përfundimit të detyrës së tyre jashtë vendit.

### REAGIMI I BABAIT

Në lidhje me rastin e katër komandove që dezertuan shërbimin ushtarak në Britaninë e Madhe, ka reaguuar edhe babai i njërit prej tyre. I shoqëruar për rastin në fjalë, babai i Aleksandrit, Lulzim Shkulaku bën me dije se djali ka bërë një veprim të nxituar



Aleksandër Shkulaku

### DENONCIMI

Ministria e Mbrojtjes ka bërë denoncim në prokurori për dezertimin e komandove. Ushtarët janë nisur drejt Anglisë në datë 4 tetor 2017 të shoqëruar nga toger Roland Poci dhe në datën 19 tetor gjatë kthimit në atdhe Ylber Tokri, Aleksandër Shkulaku, Klevis Lamkaj dhe Reni Ajazi kanë dezertuar duke vendosur të emigrojnë në këtë vend.

dhe të palogjikshëm, çka sipas tij lidhet me gjendjen e vështirë ekonomike. Lulzimi thekson se nuk ka qenë në dijeni të këtij veprimi që do të bënte i biri, madje edhe lajmin e ka mësuar nga të njohurit e tij, që jetojnë në Angli. "Lajmin e morëm vesh nga të njohurit tanë. S'kam komunikuar me të që në momentin që u nis me misionin trajnues. E konsideroj veprimin e djalit si të nxituar. I bëj thirrje të kthehet në Shqipëri. Arsyeja që ai nuk kthehet është gjend-

ja ekonomike. Shteti nuk e ka vlerësuar për kontributin e tij. Djali ka kryer edhe misionet të tjera jashtë shtetit, ku është vlerësuar me certifikata. I bëj thirrje djalit të kthehet sa më shpejt dhe të japë kontributin në vendin e tij, për veten e tij dhe familjen e tij", tha Lulzim Shkulaku. Këto deklarata Lulzimi Shkulaku, babai i komandos 22-vjeçar i ka bërë nga banesa e tij në të cilën jetonte së bashku me të birin, në një fshat në rrethin e Pogradecit.



Lulzim Shkulaku, i ati i Aleksandrit

### MEDIAT E HUAJA

Në lidhje me këtë ngjarje kanë reaguuar edhe mediat e huaja. "Daily Mail" dhe "Associated Press", të cilat shkruajnë se Ministria shqiptare e Mbrojtjes ka ngritur akuza për katër oficerët, të cilët nuk janë rikthyer më në Shqipëri, pas përfundimit të detyrës së tyre jashtë vendit.

### DËNIMI QË RREZIKOJNË

Katër komandot shqiptarë rrezikojnë deri në 5 vite burg, bazuar në Kodin Penal Ushtarak. Në nenin 33 të Kodit, theksohet se shmangia nga shërbimi ushtarak ose dezertimi dënohet deri 5 vite burg. Kodi Penal Ushtarak, shmangia nga shërbimi ushtarak, neni 33 thotë: "Dezertimi, largimi nga reparti ose vendi i shërbimit i ushtarëve dhe nënoficerëve, me qëllim shmangie përgjith-

mon nga shërbimi ushtarak, si dhe mosparaqitja e tyre me të njëjtin qëllim në repartin ose vendin e shërbimit me rastin e emërimit, transferimit, kthimit nga misioni, nga spitali ose nga leja, dënohet me burgim deri në pesë vjet. Po kjo veprë e kryer në kohë lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe kur ka sjellë pasojat të rënda, me burgim jo më pak se dhjetë vjet".

### Arrestohet 22-vjeçari, hyri për grabitje në banesën ku ndodhej e mitura

**TIRANË** - Një 22-vjeçar është arrestuar ditën e enjte në kryeqytet, pasi në bashkëpunim me shtetasin E.S. kanë grabitur një shtëpi. Ngjarja ka ndodhur në Paskuqan në banesën në pronësi të 41-vjeçares U.S.. Më datë 16.11.2017 u arrestua në flagrancë shtetasi B.B., 22 vjeç, banues në Tiranë dhe punohet për kapjen e shtetasit E.S., 26 vjeç, banues në Paskuqan, pasi në bashkëpunim me njëri-tjetrin, rreth orës 13:00, në Paskuqan 1 Kodër e Kuqe, kanë hyrë në banesën e shtetasit U.S., 41 vjeç, ku ndodhej vetëm vajza e mitur U.S 11 vjeç, të cilët e kanë mbajtur me forcë dhe kanë kërkuar brenda banesës për të vjedhur sende me vlerë. Pasi nuk kanë gjetur asgjë për të marrë janë larguar.

**SHPLLJE ANKANDI**  
Zyra Përbarimorë "E.G Baillif Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr e Bogdaneve, Pall 15, Kati 2, Tiranë, Njesia 10 njofton se me date 28.11.2017 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientin e saj, do të zhvillohet Ankandi i I për shitjen e pasurisë të paluajtshme Apartament me sipërfaqe totale 65 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr pasurie 1/154+1-4, Vol.7, Fq.247, ZK.8350 në pronësi të Z.Lirim Petrefi Kocajaj, Petref Hito Kocajaj, Fato Mojdo Kocajaj, Atin Petrefi Kocajaj, Agron Petref Kocajaj dhe Eteleva Xheladin Kocajaj me vlerë fillestare në ankand 39,000 (Tridhjetë e nëntë mijë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, email enuar.merko@gmail.com

**SHPLLJE ANKANDI**  
Zyra Përbarimorë "E.G Baillif Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr e Bogdaneve, Pall 15, Kati 2, Tiranë, Njesia 10 njofton se me date 01.12.2017 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientin e saj, do të zhvillohet Ankandi i III për shitjen e pasurisë të paluajtshme Apartament me sipërfaqe totale 61.5 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 90/199+4-2, volumi 20, faqe 164, zona kadastrale 1791 me adresë Golm, Kavajë në pronësi të Z.Minir Avif Ruga dhe Znj. Servete Behxhet Ruga me vlerë fillestare në ankand 12,390 (Dymbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) EURO dhe Apartament me sipërfaqe totale 56.5 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 90/199+4-1, volumi 20, faqe 163, zona kadastrale 1791 me adresë Golm, Kavajë në pronësi të Z.Minir Avif Ruga dhe Znj. Servete Behxhet Ruga me vlerë fillestare në ankand 11,291 (Njëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, email enuar.merko@gmail.com

**NOTIM PER SHITJE**  
Ne Zyren e Përbaruesit Gjyqësor Arjan Palla me adresë Blv.Zogu i I-re, Pall.Agimi, H-2-K-3, Ap.-5-Tiranë me dt. 20.11.2017 ora 16.00 zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë me nr. 1/197 +3-26, vol8, fq.48, zk 8260, loji I pasurisë apartament me sip. 73 m<sup>2</sup> ndodhur ne Tirane, regjistruar ne pronesi te Fazile Stafa. Cmimi me te cilin fillon shitja eshte 28405,2 Euro.

Prokuroria: Të lihet në fuqi masa e sigurisë, testi i AND-së implikon të pandehurin

Ina Allkanjari

# Vrasja e komisarit Cuku, gjykata rrezon kërkesën e Shallarit për lirim

Avokati mbrojtës: Klientit tim i rrezikohet jeta

Mikel Shallari i rrezikohet jeta, ndaj kërkoi seancë me dyer të mbyllura". Kjo deklarata u bë dje nga avokati i 24-vjeçarit në fillim të seancës së mbajtur pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda. Shallari dyshohet të jetë ekzekutori i ish-drejtorit të Policisë së Vlorës, Artan Cuku. 24-vjeçari i cili ndodhej në "arrest me burg", paraqiti në gjykatë një kërkesë për rivlerësimin e masës së sigurisë me "detyrim paraqitje". Gjatë seancës, mbrojtësi i tij kërkoi largimin e mediave nga salla. Shallari sipas prokurorisë, është njeriu që qëlloi për vdekje ish-drejtorin e policisë së Vlorës në hyrje të pallatit ku ai banonte. Analiza e AND-së konsiderohet si prova kyçe që implikon të riun në krimin e rëndë. Prokuroria kërkoi lënie në fuqi të arrestit, pasi sipas saj, testi i ADN-së implikon Shallarit si vrasës të Artan Cukut. Vetë Shallari ka pohuar se e ka pranuar autorësinë e krimit për shkak të frikës, duke ndryshuar kështu dëshminë e dhënë gjatë fazës hetimore të ngjarjes. Sakaq, Krimet e Rënda rrëzuan kërkesën e Mikel Shallarit, i cili kërkoi të rifitojë lirinë, duke lënë në fuqi masën "arrest me burg".

## KËRKESA E AVOKATIT MBROJTËS

Në fillim të seancës gjyqësore të mbajtur pranë Krimeve të Rënda ndaj të pandehurit Mikel Shallari, avokati mbrojtës, Vladimir Cjapi kërkoi që gjyqi të zhvillohej pa praninë e mediave, duke deklaruar se klientit të tij i rrezikohet jeta. Cjapi kërkoi që të mos ketë asnjë të pranishëm në sallë, përveç palëve, gjë e cila u aprovua nga trupi gjyqësor. "I nderuar, kemi informacion se incidenti mund të ndodhë në çdo moment, por s'mund ta bëj publike në praninë të personave", tha avokati mbrojtës. Cjapi



Autori i dyshuar për vrasjen e komisarit, Mikel Shallari

## MASA E SIGURISË

Mikel Shallari paraqiti në gjykatë një kërkesë për rivlerësimin e masës së sigurisë me "detyrim paraqitje". Krimet e Rënda rrëzuan kërkesën e tij, duke lënë në fuqi masën "arrest me burg".

nuk dha detaje se kush e kërcënon Mikel Shallarit, por kaq mjaftoi që zyrarët e burgjeve të vihen në lëvizje për të garantuar jetën e të paraburgosurit. Shallari ndodhet në qelitet e burgut prej tre muajsh dhe mbi bazën e dëshmisë së tij, prokuroria identifikoi dhe shpalli në kërkim personin që urdhëroi vrasjen e

kryekomisarit Cuku si dhe ndihmësin e 24-vjeçarit. Mikel Shallari tentoi të rifitonte lirinë, pasi i kërkoi gjykatës ndryshimin e masës së sigurisë nga "arrest me burg" në "detyrim për paraqitje". Pas argumenteve të paraqitura në seancën me dyer të mbyllura, gjykatësi Klodian Kurushi la në fuqi masën e sigurisë "arrest me



Komisari Artan Cuku

## AVOKATI MBROJTËS

Avokati Vladimir Cjapi kërkoi që gjyqi të zhvilloj pa praninë e mediave, duke deklaruar se klientit të tij i rrezikohet jeta. Cjapi kërkoi që të mos ketë asnjë të pranishëm në sallë, përveç palëve, gjë e cila u aprovua nga trupi gjyqësor.

burg" ndaj Shallarit. **NGJARJA**

Mikel Shallari konsiderohet nga prokuroria si ekzekutor dhe vrasës i Cukut, por porosia për këtë krim është kryer nga persona, të cilët dyshohet se pas ngjarjes janë larguar jashtë vendit. Vrasja e kryepolicit Artan Cuku ndodhi më 8 prill 2017, pranë banesës së të nd-

jerit në Rugën e Kosovareve në Tiranë. I riu nga Kuçova u arrestua më 11 qershor 2017 me kërkesë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ndërsa prova që çoi në zbulimin e tij është profili gjenetik i ADN-së, gjurmë të cilën Mikel Shallari dyshohet se ka lënë në rrobat që hodhi pak minuta pas vrasjes në një kosh mbeturinash pranë vendit të krimit.

## SHKURT

**Makina del nga rruga, plagosen 8 persona, 5 prej tyre fëmijë**

**GRAMSH** - Tetë persona, pesë prej të cilëve fëmijë të moshës 8-9 vjeç kanë mbetur të plagosur ditën e djeshme në një aksident automobilistik të ndodhur në Gramsh. Burime nga policia bënë me dije se ata udhëtonin me një fuoristradë me targë AA 572 EZ, kur makina doli nga rruga në fshatin Bërsnik i Sipërm. Mësohet se në timonin e makinës ishte një 30-vjeçar me iniciale K.D.. Sipas bluve, i riu, banues në fshatin Posnovisht ka marrë dëmtime serioze dhe aktualisht ndodhet në gjendje të rëndë për jetën. Ndërsa të lënduarit e tjerë fatmirësisht nuk paraqesin rrezik për jetën. Ata janë dërguar për ndihmë mjekësore në spitalin e Gramshit. Të lënduarit janë nga kjo ngjarje janë: N.H., 55 vjeç; M.A., 25 vjeç; K.F., 9 vjeç; E.V., 8 vjeç; A.Sh., 8 vjeç; L.V., 10 vjeç dhe H.V., 9 vjeç. Nuk dihen ende rrethanat e këtij aksidenti. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e shkakut të aksidentit.

**Digjet në Uzinë e Ferro Kromit, punëtori rëndë në spital**

**ELBASAN** - Një punëtor është djegur në uzinën e Ferro-Kromit në Elbasan. 60-vjeçari është dërguar menjëherë në spital dhe ndodhet në gjendje të rëndë. Policia po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe shkaqeve të incidentit. "Më datë 17.11.2017, duke punuar në Uzinën e Ferro Kromit, Elbasan është djegur shtetasi D.H.R. 60 vjeç, banues në Elbasan, i cili ndodhet në spital, në gjendje të rëndë. Po punohet për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes", thuhet në njoftimin e policisë.

**Përplasja në Elbasan, gjykata pushon çështjen ndaj një të akuzuari**

Gjykata ka shqyrtuar dje kërkesat e të akuzuarve, lidhur me incidentin në Elbasan në fillim të shtatorit, ku u goditë automjeti i ish-zv.drejtorit të policisë, Gjergji Oshafi nga një "Audi" i blinduar, për shuarjen e masës së sigurisë. Kërkesa është ngritur nga Valmir Dedja, Ledio Zabeli, Klemend Xhaferri, të akuzuar si protagonistë të këtij incidenti. Avokatët janë tërhequr nga kërkesa për rivlerësimin e masës, ndërsa gjykata ka vendosur të pushojë çështjen vetëm për Valmir Dedjan. Ngjarja e rëndë ndodhi mesnatën e 18 shtatorit në qytetin e Elbasanit.

## Rrëmbimi dhe vrasja e Gazmend Çollakut Prokuroria: Burg përjetë për Denis Shtrazën

Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkoi dje dënimin me burg përjetë për Denis Shtrazën, i akuzuar për rrëmbimin dhe vrasjen e Gazmend Çollakut vitin e kaluar në Durrës. Denis Shtraza e dëgjoi në heshtje kërkesën e prokurorisë për dënimin e tij me burgim të përjetshëm. I pandehuri reagoi vetëm në momentin kur përfaqësuesi i organit të akuzës identifikoi me emër mikeshën e tij, e cila ka dëshmuar me herët në gjykatë në një seancë me dyer të mbyllura. Përgjatë 40 minutave, prokurori Besnik Muçi rindërtoi skemën e

## NGJARJA

Ish-i dënuari Çollaku u rrëmbye nga katër persona të veshur me jelekë me mbishkrimin "Policia". Ai u lidh këmbë e duar dhe pasi u torturua, u qëllua për vdekje dhe u hodh anë rrugës në Murqinë të Krujës.

rrëmbimit, torturimit dhe në fund vrasjes së Gazmend Çollakut mbrëmjen e 6 janarit të vitit të kaluar në Durrës. Sipas organit të akuzës, ish-dënuari Çollaku u rrëmbye nga katër persona të veshur me jelekë me mbishkrimin "Policia". Ai u lidh këmbë e duar dhe pasi u

torturua, u qëllua për vdekje dhe u hodh anë rrugës në Murqinë të Krujës. Motivi i krimit - theksohej në dosje - është hakmarrja, pasi në 2013 Denis Shtraza i ka mbi jetuar një atentati të mirorganiuar dhe për këtë bënte përgjegjës ish-mikun e të burgut, Gazmend Çollakun.



Denis Shtraza në sallën e gjyqit

Si provë kundër Shtrazës paraqitej fakti se në makinën e oficerit të ndjerë Ervin Dalipaj u zbuluan njolla gjaku të njëjta me ato të viktimës. Por, në asnjë moment nuk u sqarua sesi implikohet i pandehuri, pasi si GPS i makinës, edhe qelizat e telefonit nuk kanë dhënë rezultate, ndërsa nuk ka dëshmitarë okularë të ngjarjes dhe

nga pamjet filmike të kamerave të sigurisë që u shfaqën gjatë procesit nuk shquhej asgjë. Pas fjalës së prokurorit, avokatët e të pandehurit kërkuan kohë për të përgatitur mbrojtjen. Denis Shtraza asnjëherë s'e ka pranuar krimin, ndërsa ka theksuar në gjykatë se me viktimën Gazmend Çollaku ka pasur miqësi.

Policia: Shkak oxhaku i mbyllur, gjimnazistët jashtë rrezikut. MASR: Pezullohet mësimi, inspektim kaldajave

# Testohet kaldaja në shkollë, asfiksohen 60 nxënës

## Mësuesi i Shupenzës: Ja si i ndihmuam fëmijët, kishte shumë tym

Enver Doçi

**BULQIZË**

Testimi për herë të parë i sistemit të ngrohjes me pellet për pak sa nuk ka shkaktuar tragjedi në shkollën e mesme "Rifat Manjani" në Shupenzë të Bulqizës. 60 nxënës të moshave 16-18 vjeç janë asfiksuar nga çlirimi i gazrave dhe tymi që është shkaktuar nga kaldaja. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se ngjarja e rëndë ka ndodhur paraditen e djeshme rreth orës 10:40. Menjëherë pas njoftimit se nxënësit e shkollës në fjalë kishin shkuar për ndihmë mjekësore në qendrën spitalore të Shupenzës, blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, policia pohoi se, "në shkollën e mesme janë ndezur kaldajat me lëndë drusore për ngrohjen e ambientit dhe në momentin e ndezjes, oxhaku i shkollës ka qenë i bllokuar dhe për pasojë tymi është shpërndarë në ambientet e brendshme të ndërtesës duke shkaktuar ndotje. Për pasojë janë asfiksuar dhe ndjerrë keq nga ana shëndetësore disa nga nxënësit e kësaj shkolle". Po sipas policisë, 34 nxënës po marrin ndihmë mjekësore në spitalin e Bulqizës dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Ndërsa, 25 nxënës të tjerë po marrin ndihmë mjekësore në spitalin e Peshkopisë dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Pas asfiksimit të 60 nxënësve, 2 prej të asfiksuarve u transportuan me helikopter në kryeqytet. Mësohet se në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" ndodhet nxënësja me inicialet A.M., 16 vjeç si dhe mësuesi P.A., 43 vjeç. Bluzat e bardha u shprehën se gjendja e tyre paraqitet e stabilizuar dhe se ndodhen jashtë rrezikut. Pas asfiksimit masiv në gjimnazin e Shupenzës, ka reaguar Ministria e Arsimit, e cila përmes një njoftimi për shtyp deklaroi se do të pezullohet mësimi në këtë shkollë derisa të bëhet ritestimi i kaldajës. Ndërkohë, ministrja Lindita Nikolla ka kërkuar nga të gjithë drejtuesit rajonalë të arsimit, ngrijeten e një inspektimi në bashkëpunim me pushtetin vendor për verifikimin e kaldajave, gjatë kësaj fundjave në të gjitha shkollat.

**MËSUESI "HERO"**  
Asfiksimi i 60 nxënësve në fshatin Shupenzë të Bulqizës (fatmirësisht pa viktima) mund të ishte shndërruar në



Gjimnazistët e Shupenzës të shtruar në spital



**SHKËLZEN BERISHA**

Djali i ish-kryeministrit Sali Berisha, Shkëlzen Berisha ka reaguar për ngjarjen e ndodhur në gjimnazin e Shupenzës. Përmes një statusi në "Facebook", Shkëlzen Berisha përdor ironinë dhe talljen për ngjarjen duke përmendur edhe ish-kryebashkiakun e Dibrës, Shukri Xhelili. "Kaldajat e shkollave, si brekët e Shukriut", - shkruan ai në "Facebook".

### Ngjarja në Bulqizë, Basha: Në rrezik nxënësit, shkollat të pasigurta

**TIRANË** - Kryetari i PD-së, Lulzim Basha ka reaguar dje lidhur me asfiksimin e 60 nxënësve në Shupenzë. Teksa shprehu shqetësimin e tij për ngjarjen e rëndë, ai theksoi se ndjen revoltë për pasigurinë e ambienteve që vënë në rrezik shëndetin e nxënësve të shkollave.

**MESAZHI I BASHËS**

Po ndjek nga afër gjendjen e nxënësve të gjimnazit të Shupenzës, të asfiksuar nga orë e mësimi nga gazi karbonik. Duke u uruar shërim sa me të shpejtë të rinjve që po marrin mjekim në Bulqizë dhe Peshkopinë si dhe për nxënësin e sjellë në Tiranë në gjendje më kritike se të tjerët, shpreh keqardhjen dhe revoltën për pasigurinë e ambienteve që vënë në rrezik shëndetin e nxënësve të shkollave. Investimet në shkollat nuk mund të bëhen pjesë e babëzisë qeveritare qendrore apo lokale. Deputeti i Partisë Demokratike, Xhemal Gjunjshi, ndodhet në Dibrë për të qenë pranë nxënësve dhe familjarëve të tyre dhe për të marrë informacion të detajuar mbi përgjegjësit e asfiksimit të 60 nxënësve të Shupenzës.



**REAGIMI I MASR**

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit bën me dije për publikun të dhënat e përditësuar mbi situatën e krijuar këtë të premte në shkollën "Rifat Manjani" në Shupenzë të Dibrës, ku në orën e dytë të mësimit ka dalë tym nga kaldaja, e cila funksionon me pellet (lloj druri i përpunuar). Për pasojë, nxënësit kanë pasur vështirësi në frymëmarrje, duke çuar në ndërprerjen e menjëhershme të mësimit dhe në transportimin e nxënësve drejt qendrës shëndetësore në Shupenzë dhe në spitalet rajonale të Bulqizës dhe Pesh-

## Ministrja Nikolla i përgjigjet Bashës dhe i kujton Gërdecin: Ju qofshi!

**TIRANË** - Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla, i është përgjigjur kreut të PD-së, Lulzim Basha për ngjarjen në Shupenzë të Bulqizës. Përmes një statusi në "Facebook", Nikolla thotë se ata fëmijë po marrin shërbimin e duhur në kohën e duhur, ndërsa Basha bën hesapet e tij duke përdorur akuza dhe revolta kundër qeverisë. Nikolla kujton dhe kohën e shpërthimit në Gërdec, ku Edi Rama u tregua sipas saj, njeri normal, dhe nuk u mor me hesapet e veta duke akuzuar.

**Statusi i Lindita Nikollës:**

Zoti Basha! Në çdo vend normal dhe bashkësi normale njerëzish nuk ndodh kurrë që politika të bëjë hesapet e veta, teksa ka rënë një fatkeqësi, cilado qoftë e për çfarëdo arsye qoftë! Sot (dje) në të gjithë po merremi me fëmijët e Shupenzës dhe ju siguroj se falë angazhimit të të gjithëve, ata fëmijë po marrin shërbimin e duhur në kohën e duhur. Ndërsa ju po bëni hesapet tuaja,



duke mos pritur as deri në sërë për të vazhduar muzikën e stonuar të gramafonit tuaj, me akuza e revolta kundër qeverisë. Disa vite më parë, u vranë 26 vetë dhe u hodhën në erë qindra shtëpi zoti Basha dhe koha më pas, tregoi edhe si, edhe pse u shkumbua një fshat i tërë, 15 minuta larg qendrës së Tiranës. Por atë ditë, në ato orë tmerrri kombëtar, Edi Rama, atëherë në rolin që ju keni sot, u tregua njeri normal i një bashkësi njerëzish normale dhe nuk u mor me hesapet e veta politike. Besoj ju kujtohet! Madje, armiku që ju ka verbuar sytë dhe errësuar komplet arsyen, mori në kurriz

edhe shumë akuza e shpotitje të pamerituara për "rrahjen e shpatullave" të kryeministrit në derën e spitalit. Po ju sot? Ju sot vazhduat me avazin tuaj vulgar të çdo dite, duke vazhduar të bëni sikur nuk ishte qeveria juaj e vjetër, që e la Shqipërinë dhe arsimin në pikën më të zehtë të hallit! Në nuk kemi bërë asnjë mrekulli, kemi ndryshuar gjëra dhe edhe më shumë do t'i ndryshojmë, po një gjë është e sigurt: Mes nesh dhe jush, mes Edi Ramës e teje, ka një ndryshim të madh si në ditë të mira, si në ditë të vështira. Është ndryshimi mes njerëzve normalë që duan ta bëjnë normal këtë vend, duke mbajtur në kurriz prej katër vjetësh, të gjithë trashëgiminë e rëndë të keq-qeverisjes suaj të gjatë dhe politikanëve anormalë. Të cilët këtë vend e duan vetëm kur i mban ata në kurriz ose përndryshe, janë gati t'i vënë shqelmin çdo ditë për të mos e lënë askënd të jetojë dhe punojë normalisht. Ju qofshi!

**MONIKA KRYEMADHI**  
Në lidhje me asfiksimin masiv në gjimnazin e Shupenzës ka reaguar edhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi. Përmes një statusi në "Facebook", Kryemadhi thotë se Bulqiza e pasurive të mëdha, njëherësh është edhe realiteti i dhimbjeve dhe varfërisë. Ajo kërkon falje për këtë realitet të hidhur, që sipas saj kemi instaluar të gjithë bashkë në këto 27 vjet.

kopisë. Aktualisht në strukturat spitalore janë shtruar afro 60 nxënës, nga të cilët njëri prej tyre është transportuar në Tiranë së bashku me një mësuese. Të dhënat nuk janë definitive, pasi po përditësohen duke qenë se situata mbetet ende në zhvillim. Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla dhe ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm me mjekët si dhe autoritetet lokale. Ministria Nikolla ka kërkuar nga të gjithë drejtuesit rajonalë të arsimit ngrijeten e një inspektimi në bashkëpunim me pushtetin

vendor për verifikimin e kaldajave, gjatë kësaj fundjave në të gjitha shkollat. Po ashtu, edhe në shkollën "Rifat Manjani" bëhet me dije se mësimi nuk do të fillojë pa bërë ritestimin e kaldajës.

**REAGIMI I KRYEBASHKIAKUT**  
Melaïm Damzi, kryetari i Bashkisë së Bulqizës ka reaguar pas ngjarjes së rëndë në fshatin Shupenzë, ku 60 nxënës përfunduan në spital pas asfiksimit që pati si shkak tymin e dalë nga kaldaja. Ai deklaroi dje për "GSH" se merr të gjitha përgjegjësitë dhe se reagimi i institucioneve ka qenë në

kohë. "Mbay të gjitha përgjegjësitë sipër. Situata u vu nën kontroll menjëherë. Ngritëm emergjencat civile të bashkisë. Si prind, si mjek kam qenë pranë spitalit për të dhënë ndihmë e parë", tha Damzi. Gjithashtu, kryebashkiaku theksoi se kjo është një ngjarje aksidentale. "Pardje u bë testimi pa nxënës dhe ishte në rregull. Kaldaja u zezë në orën 07:00 dhe u bllokua oxhaku. Kaldaja është moderne me pellet. Ka zero ndikim në mjedis. Specialistët vunë sërish në punë kaldajën, është në gjendje të mirë", pohoi ai.

**KRUJË** - Policia e Krujës ka vënë në pranga dy persona, pasi akuzohen se kanë kërcënuar një 64-vjeçar duke i kërkuar shuma të mëdha parash. Mësohet se blutë në bashkëpunim me Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë dhe Forcën e Posaçme Operacionale në Policinë e Shtetit, pas një hetimi me metoda speciale, kanë finalizuar me sukses operacionin e koduar "Sh-trëngimi", duke ndaluar 46-vjeçarim Agim Çangu dhe djalin e tij 19-vjeçar



## Shantazhuan 64-vjeçarim duke i kërkuar 20.000 euro, përfundojnë në pranga babë e bir

Gentian Çangu, banues në fshatin Nikël. Sipas hetuesve të çështjes, babë e bir, nëpërmjet mesazheve telefonike i kërkoi 20.000 euro shtetasit H.L., banues në Fushë-Krujë. Sipas burimeve të mësipërme, pas një pune të mirëfilltë hetimore është bërë i mundur dokumentimi i plotë ligjor i kësaj ngjarjeje. Burime nga poli-

cia bënë me dije se Agim Çangu dhe i biri më datë 02.11.2017 nëpërmjet mesazheve telefonike i kanë kërkuar shuma të mëdha parash 64-vjeçarit. Ndërsa, janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provave materiale: 4 celularë, 12 karta SIM të kompanive të ndryshme telefonike, një armë gjahu (teke) dhe një gëzhojë

arme gjahu me kapsollë të goditur. Materialet i kaluan Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë për veprime të mëtejshme për veprat penale "Shtrëngimi me anë të kanosjes apo dhunës për dhënien e parusisë" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive" në bashkëpunim.

### SHKURT

**I burgosuri u dhunua nga gardianët, KSHH:**

**Ngjarja u fsheh**  
**TIRANË** - Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka denoncuar dhunimin e një të dënuari në burgun e Fierit. Në një njoftim për mediat, KSHH bëri me dije se i burgosuri T.D. është dhunuar më 14 nëntor.

**DEKLARATA E KSHH:** Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) u njoftua nga ëma e të dënuarit T.D., i cili është duke ekzekutuar dënimin në burgun (IEVP) e Fierit, se djali i saj është keqtrajtuar nga punonjësit e sigurisë në këtë institucion. KSHH e vlerësoi njoftimin e mësipërm dhe e verifikoi gjendjen në vend, më dt. 16.11.2017. Në përbërje të grupit të vëzhgimit të KSHH-së ishte edhe një mjek ligjor. Gjatë këtij verifikimi rezultoi se më dt.14 nëntor 2017, rreth orës 12:00, i dënuari ndodhej në ajrim së bashku me të burgosurin tjetër; me të cilën bashkëjeton në të njëjtën dhomë, në sektorin e observimit. Në këtë kohë, i dënuari është thirrur nga grupi i sigurisë për të ushtruar kontroll në dhomën e tij. Kontrolli i mësipërm nuk zbuloi asnjë send të ndaluar. Për shkak të kontrollit ka nisur një konflikt, që sipas të dënuarit vijoi me keqtrajtimin e tij, ndërsa sipas informacionit të institucionit ku pasqyrohen konkluzionet e kontrollit ndaj të dënuarit, rezultoi se ai ka ofenduar një ndër specialistët e grupit të sigurisë. I dënuari pretendon se pas konfliktit verbal, u mor nga grupi i sigurisë dhe u vendos në një nga dhomat e veçimit, ku është goditur në pjesë të ndryshme të trupit, shenjat e të cilave janë konstatuar edhe nga ekzaminimi i jashtëm i ekspertit të angazhuar të KSHH-së (grupi monitorues). Nga ky ekzaminim u konstatuan 5 dërmishje në nivelin e artikullacioneve të gishtërinjëve të dorës së djathtë, një dërmishje gjatësore në trajtë shiriti në pjesën e brendshme të kyçit të dorës së djathtë dhe ekimozja në pjesën e mesme të brendshme të parakrahut të majtë dhe të djathtë. Vlen të përmendet se mjeku i institucionit deklaroi se nuk ka pasur informacion për këtë ngjarje, ndërsa në kartelën klinike nr. 2053, më dt. 14.11.2017 përmendet shkurtimisht se i dënuari është dërguar urgjentisht në Spitalin e Fierit, me pretendimin e tij se ka gëllitur disa copa qelqi të një ampule të thërrmur të gjetur në tualetin e dhomës. Nga verifikimi i kartelës nuk rezultoi të ketë shënime lidhur me shenjat e verifikuara si më sipër, si nga mjeku i institucionit ashtu edhe nga ekspertit mjeko-ligjor të dërguar për ekzaminim nga Shërbimi i Kontrollit të Burgjeve (SHKB). Mospasqyrimi në kartelë i vizitës që është kryer nga eksperti mjeko-ligjor i SHKB-së bie ndesh me detyrimin për dokumentimin e veprimit dhe gjendjes. KSHH e konsideron pozitive reagimin e menjëhershëm të SHKB-së dhe kryerjen e veprimeve të para hetimore, në funksion të detyrës ligjore të policisë gjyqësore.

Policia: Autorët qëlluan drejt banesës, po hetojmë në disa pista

# Pas vrasjes, sulmohet me armë shtëpia e Elton Çiços në Tepelenë

*Tre persona hynë brenda rrethimit dhe pasi u pikasën nga familjarët, morën serverin e kamerave të sigurisë*

### TEPELENË

Nuk ka paqe për familjarët e Elton Çiços. Një vit e 6 muaj pas ekzekutimit në lokalim "De Niro" në Tiranë, persona ende të paidentifikuar kanë sulmuar me armë banesën e tij në lagjen "Demokracia" në qytetin e Tepelenës. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës bënë me dije se ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Mësohet se agresorët kanë qëlluar disa herë në drejtim të shtëpisë dykatëshe ku jetojnë prindërit e Çiços dhe pasi janë pikasur, janë larguar duke marrë serverin e kamerave të sigurisë së banesës. Menjëherë pas sinjalizimit për sulmin, uniformat blu kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit.

### SULMI

Rreth orës 03:20, tre persona të armatosur kanë hyrë në oborrin e banesës së Elton Çiços, ndonëse ajo kishte rrethim afro dy metra të lartë dhe ishte e survejuar nga të katërta anët me kamera sigurie. Duke qenë se kanë shkakuar



Viktima Elton Çiço

zhurmë gjatë kësaj kohe, ata janë diktuar nga pritari i shtëpisë. Hajdutët të zënë në befasi kanë mundur të marrin nga shtëpia vetëm serverin e kamerave të sigurisë, me qëllim që të mos

identifikoheshin dhe janë larguar me shpejtësi. Ndërkaq, fqinjët e familjes Çiço pohan se kanë dëgjuar të shtëna armësh. Të terrorizuar, familjarët kanë lajmëruar policinë, e cila ka



Banesa e Elton Çiços në Tepelenë

shkuar shpejt në vendngjarje dhe ka ngritur pika kontrolli në qytet. Pas kryerjes së veprimeve paraprake, blutë pohan se po hetojnë në pistën e grabitjes dhe të një sulmi të mundshëm që po përgatitej ndaj familjes së Elton Çiços. "Nga këqyrja e vendit të ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar 5 gëzhoja. Grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes. Ndërkohë po punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve", thanë burimet policore. Banesa e Elton Çiços është grabitur disa vite më parë ku u morën një shumë parash si dhe u dhunuan prindërit e tij. Besohet se kjo grabitje sollti një zinxhir vrasjesh në kryeqytet, deri në ekzekutimin e Çiços pranë ish-Bllokut nga Jani Aliaj dhe Renato Milloshi në 1 maj të një viti më parë.

### SI NISI HAKMARRJA ÇIÇO-ALIAJ

Hakmarrje për shkak të konflikteve të kahershme mes tyre. Kjo ishte pista kryesore e vrasjes së Elton Çiços. Konfliktet mes Çiços e Aliajt ishin hapur prej vitesh dhe zanafillën e kanë në Greqi, për çështjet e pazareve të drogës. Për shkak të këtyre mosmarrëveshjeve, herë pas here ka pasur tentativa për të eliminuar njëri-tjetrin, por që kanë rezultuar të dështuara. Mësohet se Elton Çiço dhe Jani Aliaj kanë qenë në të njëjtin burg në Greqi, ku Aliaj ka qenë i dënuar me 18 vite burg për vrasje, por ka kryer vetëm 10 vite pasi është arratisur, ndërsa Çiço ishte dënuar për drogë. Pas një shëriti mes tyre, Çiço e plagosi me thikë Jani Aliajn, duke bërë që konflikti të vijojë.

United Nations Development Programme

### TENDER ANNOUNCEMENT

**Subject:** Request for proposal "Curricula Development and Training Delivery on Self-employment and Business Planning"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive proposals from interested companies who wish to be considered for the above-mentioned service.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The proposal must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked UNDP/RFP/2017-42582 "Curricula Development and Training Delivery on Self-employment and Business Planning".

For more details please refer to the link below:  
[http://procurement-notices.undp.org/view\\_notice.cfm?notice\\_id=42582](http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=42582)

Relevant dates: All interested entities should provide their proposal, not later than 4 December 2017, 14:00 hrs, to the address:

United Nations Development Programme  
"Skenderbej" Street, Gurten Center, 2nd Floor,  
Tirana, Albania  
UNDP Procurement team

**EP SA** SHQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHOQËRI NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

1- "Ara+Trulli" me sipërfaqe 582 m<sup>2</sup>, nga kjo trulli 112.2 m<sup>2</sup>, dhe ndërtesë 112.2 m<sup>2</sup>. Nr Pasurisë 6/1/241.2K. 1236, Vullm.17, Faqe.87, e ndodhur në Bucaras, Pogradec. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Tiranë Bank sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **110.800 Euro**. Ankandi zhvillohet datë 11.12.2017 ora 16.00 në adresën Rr."L. Oemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.

2- "Trulli" me sipërfaqe 3.942 m<sup>2</sup>, Nr Pasurisë 731/45, Zona Kadastrale: 2648, Vullm.7, Faqe.110, e ndodhur në Mermelisht, Pogradec. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Tiranë Bank sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **59.602 Euro**. Ankandi zhvillohet datë 11.12.2017 ora 16.00 në adresën Rr."L. Oemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane

Per cdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në [www.epsa.al](http://www.epsa.al)





Studentët e pedagogë gjatë diskutimit të problematikave

Tryeza e diskutimit, tarifa të papërbalueshme, sidomos në nivelin master

Voltiza Duro

# Studentët e UT: Ngacmimet seksuale në universitete nuk denoncohen

## "Duhet të ndihemi të qeta e të sigurt"

**T**arifat e papërbalueshme të studimit, veçanërisht në nivelin master dhe ngacmimet seksuale në universitete ishin dy nga pikat që u diskutuan nga studentët në ambientet e Fakultetit të Shkencave Sociale. Në Ditën Ndërkombëtare të Studentëve, Lëvizja "Për Universitetin" në bashkëpunim me studentët e pedagogë nga fakultetet e Universitetit të Tiranës organizuan dhe tryezën e diskutimit për gjendjen e universitetit publik. Studentët njëzëri u shprehën se tarifat e programeve të studimit janë të papërbalueshme financiarisht dhe se do të kërkojnë fuqimisht uljen e tyre sa më shpejt të jetë e mundur. Ata kërkuar edhe që të mos penalizohen nga provimet studentët që nuk kanë mundësi të paguajnë në kohë.

dardeve e kualitetit të fakultetit ku bëjmë pjesë", - u shpreh studentët nga trojet, që ndjek studimet në UT. Studentët thanë se tarifat e larta, përpos jetesës e qirasë që duhet të paguajnë, i kanë detyruar shumë prej tyre që të punojnë njëkohësisht në vende ku më tepër shfrytëzohen sesa paguhen. Më tej studentët diskutuan edhe mbi ngacmimet seksuale që hasin në auditorët e universitetit. Sipas tyre, në shumë raste nuk mungon presioni e sjelljet e patolerueshme në ambientet e shkollës, por kjo temë jo vetëm që nuk denoncohet, por edhe nuk diskutohet e kalon në heshtje. Një shqetësim tjetër që u prek nga të pranishmit gjatë diskutimit ishte edhe pagesat që duhet të bëjnë studentët

### TARIFAT

Studentët njëzëri u shprehën se tarifat e programeve të studimit janë të papërbalueshme financiarisht dhe se do të kërkojnë fuqimisht uljen e tyre sa më shpejt të jetë e mundur. Ata kërkuar edhe që të mos penalizohen nga provimet studentët që nuk kanë mundësi të paguajnë në kohë.

për të marrë vërtetimet, si dhe procedurat e te zgjidhura për t'i tërhequr pranë sekretarive mësimore. Më tej, ata kërkuar edhe që të mos penalizohen nga provimet studentët që nuk kanë mundësi të paguajnë në kohë dhe të ofrohet për ta një zgjidhje më lehtësuese. Edhe pedagogët të pranishëm në këtë tryezë diskutimi u bashkuar studentëve dhe theksuan se shpejt do të hartojnë një peticion me pikat më të rëndësishme për t'ua

paraqitur instancave përkatëse. Ata bënë me dije se nëse nuk marrin një përgjigje pozitive, do të ndjekin çdo rrugë të mundshme për të realizuar kërkesat në ndihmë të studentëve, përfshirë këtu edhe protestat. Pedagogia e Fakultetit të Shkencave Sociale, Orinda Malltezi, diskutoi edhe mbi çështjen e akreditimit të Universitetit të Tiranës. "Ne kemi probleme, por realiteti nuk është aq i zi sa u paraqit nga agjencia

### CEREMONIA




## Tirana feston 73-vjetorin e Çlirimit

**M**e rastin e 73-vjetorit të Çlirimit nga pushtuesit nazifashistë, u zhvillua ceremonia e përkujtimit të kësaj dite dhe sakrificës që mijëra të rinj dhe të reja bëjnë për çlirimin e kryeqytetit. Në shenjë mirënjohjeje dhe nderimi, për të gjithë ata që dhanë jetën për çlirimin e Tiranës, si dhe për ata qindra të tjerë që u bënë pjesë e luftës antifashiste, në monumentin e "Ushtarit të Panjohur" u vendosën kurora me lule. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ministria, deputetë, përfaqësues të qeverisë, anëtarë të Këshillit Bashkiak, si dhe dhjetëra veteranë të Luftës Nacionalçlirimtare. Në fjalën e tij, kryebashkiaku Veliaj shprehu mirënjohjen për sakrificat dhe veprën që të rinjtë e të rejtat bëjnë për çlirimin e kryeqytetit dhe njëkohësisht familjet tiranase që hapën dyert e mikpritjes. "Dua të falënderoj të gjitha familjet e dëshmorëve, të veteraneve, ata që kontribuuan për luftën, e atyre familjeve nga Tirana që hapën shtëpitë e tyre, apo atyre që sakrifikuar, pavarësisht se nuk ishin nga Tirana, për çlirimin e qytetit tonë", deklaroi Veliaj.

### GRESA HASA, STUDENTE

## "Ngacmimet seksuale në universitete nuk denoncohen"

**D**ua të ngre një problem të rëndësishëm dhe jo fort të ndjekur, që është ngacmimi seksual në universitete. Ditët e sotme një sërë studentesh ballafaqohen me presionin, me sjellje që janë krejtësisht të papranueshme në mjedisin universitar. Ndërkohë që ky i fundit supozohet të jetë një vend ku studentit të vijë dhe të ndihet i mbrojtur, i sigurt, pra të jetë si në "shtëpinë" e tij. Ka shumë raste që jo vetëm nuk denoncohen, por nuk trajtohen fare dhe kalojnë në heshtje, nuk janë temë diskutimi. Kjo është një thirrje që u bëj jo vetëm vajzave, por edhe djemve studentë, pasi mendoj se dhuna gjinore që manifestohet edhe me ngacmimin seksual është një çështje që na përket të gjithëve. Në universitet edhe vajzat, edhe djemtë duhet të jenë të sigurt dhe të qetë, psikologjikisht dhe fizikisht", - u shpreh Gresa Hasa, studente e UT-së.



### ARLIND QORI, PEDAGOG

## "Do të përshkallëzojmë veprimin në protesta"

**P**asi ne të ngremë problematikat, duhet të hartojmë një listë me 5, 6 apo 7 pika që janë "ulëritëse", pra më të rëndësishme e këtë listë ta drejtojmë të të gjitha autoritetet që janë përgjegjëse, që nga rektorati deri të qeveria. Por të firmosësh peticionin do të thotë që të angazhoheni edhe që të bëjmë dicka nëse kërkesat tona nuk plotësohen, pra të bëjmë ç'është e mundur që të arrijmë plotësimin e objektiveve e të drejtave tona. Shumë shpejt do të shkojmë në çdo fakultet, do sintetojmë kërkesat bazike, ta dorëzojmë të autoritetet e t'u japim këtyre të fundit një afat racional për përgjigje. Në rast të një përgjigjeje negative, duhet të përshkallëzojmë veprimin dhe të organizojmë protesta ose në akte të tjera të rezistencës. Koha kur paguhen tarifat është janari, e në rast se ne e çojmë zërin tonë, mund të arrihet të ulen tarifat", - tha aktivisti Arlind Qori.



### KLODI LEKA, STUDENT NË UT

## "Paguajmë para për vërtetimet, ndeshemi me burokraci"

**S**tudentët tani fillojnë të punojnë që në vitin e parë të universitetit, pra nuk kanë kohë të lexojnë, të studiojnë, të ndjekin të gjitha leksionet. Janë shkatërruar mendërisht, pasi dhe në vendet e punës paguhen keq, shfrytëzohen. Studentët kanë frikë të hyjnë në fakultet, pasi duket sikur do i gjobisin për çdo vërtetim, për çdo libër, për çdo akt shumë të thjeshtë kërkojnë lekë. Gjithashtu, studentët që të marrin një vërtetim, një listë notash, duhet të ndeshen me burokraci nga më të ndryshmet dhe të përballen edhe me tarifë që duhet t'i paguajnë për t'i tërhequr, kanë apo s'kanë lekë. Kjo është një kosto e tepërt për studentët. Gjithashtu, kërkojmë që për studentët që nuk paguajnë dot në kohë, të krijohen lehtësira e të mos nxirren me shkelma nga fakulteti, pra të gjendenet një zgjidhje", - u shpreh Klodi Leka, student i UT-së.



Drejtori i shoqatës: Gjithçka shkon dëm nëse nuk realizohet rimbursimi i fishave

Voltiza Duro

# Diabeti, Asim Toro: Shteti mbulon vetëm 1/3 e shpenzimeve për mjekimet

## "Paragjykohemi nga shoqëria shqiptare"

N umri i rasteve të per sonave të prekur nga diabeti po rritet ndjeshëm në vendin tonë nga viti në vit. Muaji nëntor njihet si muaji sensibilizues në luftë kundër kësaj sëmundjeje ku të prekurit ngrenë zërin për problematikën e tyre, veçanërisht për kostot e larta financiare që duhen për të mbuluar trajtimet mjekësore. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Asim Toro, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së Fëmijëve dhe të Rinjve me Diabet në Shqipëri kërkon nga shteti shqiptar rimbursimin e fishave për matjen e glicemisë dhe lehtësimin ekonomik të kësaj kategorie. Gjithashtu, ai thotë se kërkesat e tyre për vite kanë rënë në vesh të shurdhët, e bën thirrje instancave përkatëse për bashkëpunim.

### Sa është nr. i personave me diabet në vendin tonë?

N umri i personave të prekur nga diabeti në vendin tonë arrin shifrën 75 mijë, e ndër to rezultojnë 1500 fëmijë e të rinj me këtë sëmundje. Vlen të theksoj faktin se numri i tyre është në rritje nga viti në vit, çka përbën një shqetësim për të cilin duhen marrë masat e duhura parandaluese.

### Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të prekurve nga kjo sëmundje?

Faktor i kryesor i rritjes së numrit të personave me diabet vjen nga kequshqyerja, sidomos këtu ndikon konsumimi i ushqimeve të thata. Gjithashtu, edhe mungesa e aktivitetit fizik është një tjetër shkak që ka ndikuar, pasi njëzëri shumë herë e neglizhojnë dhe kur sëmundja "troket" është shumë e vështirë që të përballen, aq më tepër me diabetin. Edhe stresi është një ndër faktorët që ka sjellë këtë rritje të të prekurve nga kjo sëmundje, e kur personi është me diabet, stresi sjell përkeqësimin e gjendjes së pacientit.

### Sa shkojnë kostot për trajtimet mjekësore për një të sëmurë me diabet?

Kostot arrijnë plot 320 mijë lekë të vjetra në një muaj, në një kohë që kemi që na jep shteti është 100 mijë lekë të vjetër, pra na siguron vetëm 1/3 e shpenzimeve që na duhen për trajtimet mjekësore.

### A është i mjaftueshëm trajtimi që merrni nga ana e shtetit?

Për vite me radhë, ky shtet nuk ka vënë dorë në asgjë, përveç rimbursimit të insulinës. Ne duhet të kalojmë shumë procedura e sorollatje të kota për të marrë një insulinë më tepër nëpër rrethe e shpesh ndeshemi edhe me neglizhencën e mjekëve, të cilët nuk na japin mbi 8 pena. Nëse duam një më tepër duhet të paraqiten nga qytetet e tjera në Tiranë, çka ka



Asim Toro, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së Fëmijëve dhe të Rinjve me Diabet në Shqipëri

### KERKESA

Kërkesa jonë kryesore është rimbursimi i fishave që bëjnë matjen e glicemisë. Gjithashtu, kërkojmë edhe sigurimin e reagentëve të hemoglobinës së glukozuar si dhe sjelljen e medikamenteve më të fundit nga jashtë për kurimin tonë, pasi shteti shqiptar gjithë këto vite nuk e ka bërë këtë gjë duke mos i dhënë vëmendjen e duhur kategorisë sonë.

edhe shumë kosto. Insulinat vërtet zënë kosto të madhe në buxhetin e shtetit, por çdo gjë shkon dëm n.q.s. nuk realizohet rimbursimi i fishave.

### Cilët janë kërkesat tuaja kryesore ndaj shtetit shqiptar?

Kërkesa jonë kryesore është rimbursimi i fishave që bëjnë matjen e glicemisë. Gjithashtu, kërkojmë edhe sigurimin e reagentëve të hemoglobinës së glukozuar si dhe sjelljen e medikamenteve më të fundit nga jashtë për kurimin tonë, pasi shteti shqiptar gjithë këto vite nuk e ka bërë këtë gjë duke mos i dhënë vëmendjen e duhur kategorisë sonë.

Me bashkëpunimet që kemi pasur në seancat dëgjimore të parlamentit, u arrit që në dhjetor të 2016 të sigurohej një fond prej 23 milionë lekësh të reja që do të për-

dorej për sigurimin e fishave për fëmijët. Ky fond nuk e dimë se ku ka përfunduar pasi ne nuk e morëm kurrë rimbursimin. Një tjetër kërkesë e rëndësishme është mundësia të 50 pompave për gratë shtatzëna që ta kenë shtatzëninë nën kontroll.

### A i keni raportuar problematikat tuaja drejt instancave përkatëse?

Kemi dërguar kërkesa nga më të ndryshmet drejt instancave përgjegjëse, si Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyruar të Kujdesit Shëndetësor, në dijeni të Ministrisë së Shëndetësisë madje kemi bërë dhe një peticion të firmosur nga 2500 persona në vitin 2016. Por kërkesat tona kanë rënë në vesh të shurdhët dhe s'kemi marrë ende asnjë zgjidhje.

### Cili ka qenë reagimi i Ministrisë së Shëndetësisë ndaj kërkesave tuaja?

Ministria e Shëndetësisë nuk na ka përkrahur madje na ka thënë se kanë ngritur grupe pune për zgjidhjen e problematikave që na shqetësojnë, por ne nuk kemi qenë prezentë gjatë mbledhjeve të tyre.

### Sa e vështirë është për këtë kategori që të sigurojë një vend pune?

Shteti ynë shpeshherë nuk pranon persona që janë të sëmurë me diabet për t'u dhënë një vend pune dhe kjo bën që të prekurit në shumicën e rasteve mos të prononcohen për sëmundjen, madje dhe përpigjen që ta mbajnë sa më të fshtë.

### PARAGJYKIMET

Gjatë gjithë kohës shumica e personave me diabet e fshehin faktin që janë të prekur nga kjo sëmundje. Njerëzit thonë që nuk na paragjykojnë, por realisht paragjykohejmë shumë, qoftë edhe me një shikim. Madje disa prej tyre arrijnë të mendojnë se është edhe ngjitës, e kjo na bën të ndihemi shumë keq.

themeluar nga anëtarë me diabet prej vitesh në 5 shkurt të 2013-ës. Ajo çka kemi kërkuar që në fillim ka qenë bashkëpunimi me organet kompetente, por pavarësisht se pretendojnë se krijojnë grupe pune ku diskutojnë mbi diabetin, neve nuk na kanë ftuar për të folur mbi problemet që realisht shqetësojnë kategorinë tonë. Deri më tani janë regjistruar 400 anëtarë dhe ne operojmë edhe me degët tona në rrethe, por mundësitë financiare janë të pakta. Kjo pasi rrallë arrijmë të gjejmë donator.

### Cilat janë disa prej aktiviteteve të realizuara prej shoqatës suaj?

Shoqata jonë, me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës e Ministrisë së Kulturës ka organizuar shumë aktivitete sensibilizuese. Në muajin e ndërgjegjësimit në luftën kundër diabetit, shoqata jonë realizoi shumë aktivitete. Në datën 5 nëntor realizuam pedalimin me biçikleta.

### A e ndieni veten të pranuar nga shoqëria shqiptare?

Gjatë gjithë kohës shumica e personave me diabet e fshehin faktin që janë të prekur nga kjo sëmundje. Njerëzit thonë që nuk na paragjykojnë, por realisht paragjykohejmë shumë, qoftë edhe me një shikim. Madje disa prej tyre arrijnë të mendojnë se është edhe ngjitës, e kjo na bën të ndihemi shumë keq.

### Cila është thirrja tuaj për të gjithë të sëmurët me diabet?

I bëj thirrje të gjithë atyre që iu duhet të bashkëtojnë çdo ditë me diabetin, të mos fshihen, të ngrenë zërin për t'u ndjerë të barabartë në shoqëri, të mos tregohen inferior!



Edhe te sektori privat shfaqen problematika, pasi shumë rrallë plotësohen kushtet e punonjësve me diabet si t'u ofrohen mundësi për të matur gliceminën apo për të bërë insulinën. Edhe unë vetë e kam hasur këtë shqetësim, pavarësisht se

kam aplikuar, nuk më janë dhënë hapësirat që të fitoj vendet pune, kështu që jam marrë vetëm me drejtimin e shoqatës.

### Kur është krijuar shoqata tuaj e cili është misioni i saj?

Shoqata jonë është

## Rritet rezistenca ndaj antibiotikëve, kërcënim edhe për Shqipërinë

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka dhënë alarmin se rezistenca ndaj antibiotikëve po kthehet në kërcënim serioz, edhe në vendin tonë. Një studim i kryer me mbështetjen e OBSH-së, për Europën dhe Zyrën së saj në Tiranë tregon se në Shqipëri është rritur rezistenca ndaj të paktën 4 antibiotikëve, sa i takon patogjeneve ushqimore si salmonela, të cilat sjellin problematika të theksuara shëndetësore. Por ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu,

gjatë takimit ndërsektorial për rezistencën mikrobike, tha se Shqipëria është pjesë e përpjekjeve globale për adresimin e këtij kërcënimi e se lufta ndaj antibiotiko-rezistencës është një nga fushat prioritare të shëndetit publik në vend. "Ne do të marrim masa për t'i forcur kontrollat në zbatim të këtij ligji, por është e rëndësishme që secili prej nesh të ndërgjegjësohet dhe të mos keqpërdorë antibiotikët, pasi rezistenca ndaj tyre na rrezikon të gjithëve", u shpreh Manastirliu.

Opinion i Ditës

Nga Ilir Meta

(Vijon nga faqja e parë)

... dhe shkëmbimet midis tyre kthehen në pasuri të përbashkëta dhe kontribuojnë veçanërisht në drejtim të forcimit të miqësisë ndërmjet popujve.

Arti, muzika, kultura dhe shkenca jo vetëm që kanë magjinë për të ndërtuar ura mes popujve, por edhe për t'i paqësuar dhe për t'i bashkuar ata.

Shqipëria është shumë me fat që historikisht ka pasur mbështetjen e një mikut të besueshëm dhe një aleati të fortë, siç është Austria.

Shqiptarët do të jenë përgjithmonë shumë mirënjohës për mbështetjen e palëkundur të ofruar nga Austria për themelimin e shtetit të pavarur shqiptar, gjatë viteve më të vështira të ekzistencës së kombit shqiptar, kundër kërcënimeve të fqinjëve dhe synimeve të tyre për zgjerimin territorial në dëm të Shqipërisë.

Babi i kombit, Ismail Qemali vendosi të shpallë pavarësinë e Shqipërisë vetëm pasi kishte siguruar mbështetjen diplomatike për Shqipërinë dhe të gjithë shqiptarët gjatë takimeve të tij në Vjenë dhe Budapest.

Sot, Austria vazhdon të na mbështesë jo vetëm në përpjekjet tona për të ndërtuar një vend demokratik, të qëndrueshëm dhe



modern, por është gjithashtu, një avokate e rëndësishme në rrugën tonë të pakthyeshme drejt integritit në Bashkimin Evropian.

Marrëdhëniet tona të shkëlqyera janë forcuar dhe pasuruar historikisht jo vetëm nga kontributet dhe trashëgimia e politikaneve dhe

diplomatëve. Albanologët, gjuhëtarët, shkencëtarët dhe intelektualët nga Austria dhe Shqipëria janë gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e kësaj trashëgimie të çmuar. Johann Georg von Hahn, Gustav Meyer, prof. Herman Ölsberg, profesorët Aleks Buda,

Eqrem Çabej, Skënder Luarasi dhe Lasgush Poradeci, si edhe artistit i jashtëzakonshëm i skenës teatrale të Vjenës, Aleksandër Moisiu, u shndërruan në një frymëzim për artistët shqiptarë dhe austriakë.

Ndihem krenar që ndodhem këtu sonte si dëshmitar i një epoke

të re, ku artistët e talentuar shqiptarë përforcojnë me dinjitet në skenat dhe teatrot e Austrisë dhe të Evropës. Ata janë prova e pakundërshtueshme e marrëdhënive të shkëlqyera midis dy popujve dhe vendeve tona.

Ata janë të përzgjedhurit e popullit tonë të lashtë dhe përfaqësuesit e traditës, kulturës dhe trashëgimisë sonë dhe në të njëjtën kohë, pasardhësit e brezave të artistëve dhe intelektualëve shqiptarë ndër vite. Inva Mula, Genc Tukiçi, Eno Peçi, Etlëva Shemai, Olen Çezari dhe Gëzim Myshketa, së bashku me Volkhard Stuede e Maria Yakovleva, si edhe organizatorët e kësaj mbremëjeje kaq të bukur gëzojnë jo vetëm vlerësimin tim, por edhe respektin dhe nderimin më të madh që na bënë bashkë të gjithëve në këtë skenë të mrekullueshme në zemër të Vjenës, kryeqytetit të artit dhe muzikës, për të festuar 105-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë.

Jam i lumtur që në mbyllje të fjalës sime, të shpreh një falënderim të veçantë për Presidentin Fischer, për gjithçka që ai ka bërë për marrëdhëniet shqiptaro-austriake përgjatë të gjithë aktivitetit të tij të mrekullueshëm politik ndërkombëtar dhe akoma më shumë, si Presidenti i Republikës së Austrisë.

## REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING COMPANY)

### ALBANIA

CITIZEN - CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT  
Loan Agreement  
Project ID No. 8521

Assignment Title: Advisory Support for Validation of Services provided with Improved Front Office

Ref. No. ALB-8521/CS/CQ/3.10.02

As part of the reform, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA), was established in October 2014 to manage the centralized public service delivery to the citizens. Its expanded mandate includes the implementation of the separation of the front office (FO) from the back office (BO) in all central institutions, aiming to improve access to public services as well as the quality of service delivery through establishing of service, based on a customer-care culture.

To implement the program, the Government of Albania has received financing from the World Bank. The Project Management Unit, the Ministry of Innovation and Public Administration (MIPA) as the lead implementation agency supported by the Delivery Unit at the Prime Minister's Office, and ADISA, as beneficiary agency under the ISDA program, manages the technical aspects of the activities.

Under the second pillar, the program aims to improve public service delivery in Albania through a citizen-centric model, through establishing integrated centers/one-stop shops. ADISA is currently managing one front office at IPRO in Tirana and four One Stop Shops in four different cities. These new facilities offer citizens and businesses improved physical access to public services, with improved customer service culture and standards regarding the delivery, aiming for reduced transactions time and a reduction in petty corruption.

The results of key activities are linked to Disbursement Linked Indicator (DLI#3) - Services offered with improved customer service front office interface - that will be verified/ validated through a third party. For this purpose, ADISA is seeking a consulting company (hereafter referred to as the Consultant) to conduct such verification exercise. The Consultant is expected to develop the methodology, conduct data collection and analysis, and prepare the findings/verification/certification report.

The scope of work is to conduct an in-depth assessment to measure (a) improved access to services and (b) improved quality of services, as measured by professionalism, courtesy of staff, queue management and waiting times; easiness of application process, standard application forms, personnel dressing and presentation, information desk, complaint management, etc.

The key tasks and main activities the Consultant is expected to carry out include, but not limited to, the following:

1. Design a comprehensive and clear methodology proposing multiple method approach to gather the needed information (both qualitative and quantitative), in order to reach all target groups. Some potential data sources could include, but might not be limited to, exits surveys, direct observations, focus groups, etc. Secondary data would be useful to use as well to complement the primary ones.
2. Design the instruments for data collection to make sure all necessary data on access, customer service, corruption, etc., are collected. The data collection instruments should be agreed upon with the Client/ADISA before implementation.
3. Implement the agreed methodology to collect the necessary data. The data collection should be carried in multiple location (all FO/OSSH) to allow also for comparisons of the number of services available at each location, etc.

4. Perform data analysis and produce the verification report.

The Project Management Unit now invite eligible "Consultant" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The Consultant shall possess and be able to prove the following qualifications, experience, skills and competencies:

- At least 10 (ten) years of professional consulting experience with a focus on assessment, in-depth review of customer services at front offices operation in public or private sector.
- Proven experience in designing and implementing research methodology, including both qualitative and quantitative approaches.
- Previous experience in World Bank funded projects and/or DLI verification will be an advantage.
- Fluency in English language, spoken and written (for key members of the team); and
- Availability of staff with necessary qualifications and experience to successfully carry out all the tasks and deliverables of this assignment. These include but not limited to the following:

**The Team Leader /Survey Researcher** shall possess the following qualifications:

- (a) Master's degree and demonstrated experience in economics, business management, development economics, or related fields;
- (b) Minimum of ten (10) years professional experience in designing and implementing of assessment related to customer service in public or private sector as well as proven experience as team leader;
- (c) Proven experience in carrying out/ leading such assignments/ third party verification, working for large institutional donor supported projects.

**The Fieldwork Coordinator**, who is expected to administer the foreseen field activities, and provide technical oversight and guidance to the field team to ensure collection of quality data, shall possess the following qualifications:

- (a) Master's degree or demonstrated experience in economics, business management, or related fields;
- (b) Minimum of five (5) years professional experience in managing field activities and ensuring compliance with the survey methodology at all levels of data collection;
- (c) Very good understanding of customer service in public or private sector;

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualifications method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The notification is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): [www.adisa.gov.al](http://www.adisa.gov.al).

Expressions of interest (CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by November 30, 2017, at 12:00 local time

Project Management Unit Blvd: Zhan d'Ark,  
Ish shtëpia e oficerave, Kati V-te Tirana, Albania  
E-mail: [roland.larashi@inovacioni.gov.al](mailto:roland.larashi@inovacioni.gov.al); and  
[ccsdprojectalbania@gmail.com](mailto:ccsdprojectalbania@gmail.com)

Opinion i Ditës

Delvina Kërluku

(Vijon nga faja e parë)

...ceremoninë e dorëzimit të çmimit "Zhan Mone", foli në gjuhën serbe, duke mohuar gjuhën maqedonase dhe atë shqipe. Mesazhet e kësaj sjelljeje secili i mori në mënyrën e vet. Shkrimi im, përveç se në gazetën e përditshme "Koha" të Shkupit, u botua edhe në disa mjete të tjera shqiptare, si në Tiranë, po ashtu edhe në Prishtinë e gjetiu. Në disa kolegë gazetarë shqiptarë, e komentua midis vete këtë gjest aspak diplomatik të diplomatit evropian, por jehona ishte e paktë, sidomos nuk pati asnjë reagim nga partitë politike shqiptare, edhe pse mohohej gjuha e tyre, për të cilën rrahin aq shumë kraharorët partiakë. Të paktën të kishte përshëndetur në gjuhën angleze, e cila tanimë ka marrë letërnjoftimin e gjuhës së diplomacisë, por të cilën edhe e njohin shumica e gazetarëve. Më në fund përkthyesit atë punë kanë, e të cilët nuk mungojnë në evente të tilla. Dhe, nuk duhet të mungojnë. Në atë mbrëmje nuk mungoi audiencia e gjerë, por as mediat e shumta të vendit dhe të huajat. Aty ishin edhe mediat në gjuhën shqipe. Dhe fjala e diplomatit evropian (me përkatësi etnike sllovene), befasoi me dushin e ftohtë. Siç thashë, të nesërmen nuk pati reagime qenësore, sikur të mos kishte ndodhur ndonjë gjë e madhe. Mos ishte ky gjest, manifestim i një servilizmi të tepruar, apo ndonjë urdhër-rekomandim nga lart, mbetet të hohet e të shihet. Skandale me mosrespektimin e gjuhëve në kryeqendren tonë kanë ngjarë edhe më parë. Ndodhi edhe disa muaj më herët me gazetaren nga Shqipëria, Sonila Meço, kur iu drejtua auditorit në gjuhën angleze, e jo në shqipen e saj. Unë shkrova edhe për këtë rast. Shkrimi pati jehonë, por jo edhe ndonjë efekt konkret.

Më ka rastisur që shpesh të raportoj aktivitetet në selinë e Bashkimit Evropian për gazetën ku punoj. Shumë herë ka qëlluar të luaj rolin edhe të përkthyesit në gjuhën shqipe, pasi organizatori nuk e ka parë të arsyeshme të respektoj ligje e konventa për barazinë e gjuhëve. Gjithmonë është kënaqur me përdorimin e dy gjuhëve: anglisht e maqedonisht. Po shqipja që flitet, të paktën, nga një e treta e popullatës, ku na mbeti! Mediat në gjuhën shqipe përse anashkalohen Evropë na lodhi me sloganet e barazisë, por ja që mban një qëndrim tjetër (mos themi diskriminues) ndaj shqipes dhe shqiptarëve. Gjuha shqipe mbeti çështje e hapur, e cila nuk po mbyllet me dekada. Në çdo fushatë zgjedhore partitë atunë kryesore e kanë rregullimin me ligj të përdorimit (zyrtar) të gjuhës shqipe. Mirëpo, sa kalonin zgjedhjet dhe verifikohen mandatat, premtimet e zotimit i merr era dhe deputetët vazhdojnë të bëjnë veshin shurdh dhe ia kriasin gjumit letargjik (hipokrit). Çështja e përdorimit të saj po përlëtitet Paq shumë edhe ditëve të sotme në Parlamentin e Maqedonisë. Na



ka zënë veshi të dëgjojmë se ligji që po trajtohet përmban flamurin (rekomandimin) e BE-së. Sa mirë! Por përse ajo vetë nuk e përfill këtë rekomandim, kur në aktivitetet që organizon zyra e saj në Shkup, shqipja e ka vendin prapa derësë. Se të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni duhet të shënojnë progres shumë më të dukshëm e të prekshëm, përmes një zbatimi sa më real e më konkret edhe të vetë marrëveshjes së Ohrit. Përfaqësuesit e BE-së kanë deklaruar se Maqedonia konsistohet si shtet sovran dhe i pavarur dhe si shtet qytetar dhe demokratik. Na kanë thënë se angazhohen për të siguruar sundimi i së drejtës, si sistemi themelor i pushtetit; të garantohen të drejtat e njeriut, lirite qytetare dhe barazia nacionale; të sigurohet pagja dhe bashkë jetesa e popullit maqedonas, me

kombësitë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë; të sigurohet drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës personale dhe të përbashkët, etj., etj. Por, këtu ndodh ndryshe. Kur ligjin e shkëlpin vetë ligjvënësit! Rezulton të jetë shndërruar në shembullin se si rregullorja dhe ligjet, shkelen në mënyrë flagrante, para mediave, në tempullin ligjvënës - Kuvendin e Maqedonisë. Kjo shihet edhe në konferencën "Ditë e medias, BE - Ballkani Perëndimor", e zhvilluar nga Komisioni Evropian, disa ditë më parë në Tiranë. Si shumë herë më parë, barazia kombëtare dhe gjuhësore: në këtë aktivitet kaq të rëndësishëm, organizatori është "kuqdesur" që të mos ketë të pranishëm asnjë përfaqësues të mediave shqiptare në Maqedoni, por vetëm të maqedonasve (bashkë me

zëdhënësin e qeverisë, Mile Boshnjakovski). Aty është folur për lirinë e mediave, por nënkuptohet që me këtë nënkuptohet mediat në gjuhën maqedonase. Ato shqiptare, si ta kenë punën! Kush pyet për to! Përveç se diskriminim klasik, nuk gjen emër tjetër për këtë veprim. Dhe kështu do të jetë, derisa partitë shqiptare të kthjellohen dhe barazinë e gjuhës së tyre ta marrin pak me seriozitet.

Këtë qëndrim diferencues kjo Zyrë e ka edhe për çmimet që ndanë për gazetarët. Brenda tri vitesh, aq sa unë jam në djeni, pasi e ndjek këtë veprimtarë si gazetar, nuk është ndarë asnjë çmim për asnjë disiplinë gazetare. Porosia del e qartë: Evropës (kësaj Zyre) i intereson vetëm një popull dhe vetëm një gjuhë. Ose: shqiptarët s'kanë gazetari për të qenë!

# Ç'është ky diskriminim që përsëritet e përsëritet?!

## HOROSKOPI

### DASHI

Ndryshime të shpejta dhe pozitive, falë pozicionimit të Hënës në lidhje me Neptunin. Në vazhdim të vendimeve të marra, popullariteti juaj do të pësojë një rritje! Pak krijimtari dhe fantazi në profesion do t'ju sjellë vlerësimin e një eprori.

### DEMI

Dilni nga kllapia dhe veproni menjëherë, nëse nuk doni që të ngelin mbrapa. Gjë që nuk është kushti se çfarë, zakonisht. Për të gjetur çelësin e problemit, nevojitet që të keni qetësinë e duhur mendore dhe të mos shpejtoni.

### BINJAKET

Me Hënën, që ndodhet te Bricjapi, bën që të jeni më materialist sesa zakonisht. Por fatmirësisht pozicionimi i Saturnit do t'ju ndihmojë që të çlironi fantazinë. Ndoshta zgjedhja që do të bëni nuk është ajo që do të pritej nga ju, po përdorni imagjinatën.

### GAFORJA

Kujdes nga kokëfortësia, sepse mund të sjellë gjëra të pakëndshme. Më mirë të udhëhiqeni nga dikuj që ka më shumë përvojë sesa ju. Përvoja ju mëson, por nëse nuk jeni të sigurt për diçka 100%, nuk duhet as ta provoni.

### LUANI

Një ditë pa shumë bujë. Nëse mendoni se meritoni më shumë, nuk keni bërë logaritë me ata me të cilët duhet të ndani meritat. Në fund do të dini si ta menaxhoni situatën, pasi nuk doni që të dilni keq.

### VIRGJERESHA

Krijimtari e madhe falë Hënës që ndodhet te Bricjapi. Jeni të palodhshëm, të aftë për të punuar pa ndaluar. Nganjëherë, megjithatë, nuk e kuptoni që e tejkaloni masën. Një ofertë pune duket shumë premtuese. Çfarë prisni për ta pranuar? Mos humbni kohë!

### PESHORJA

Shfrytëzoni Hënë që ndodhet tek Bricjapi për të zmadhuar dhuntitë e juaja dhe të përdorni çdo mënyrë për të vënë në vijë punët tuaja. Nganjëherë nuk duhet të lodhni shumë për të rënë në sy, mjafton të zgjidhni me kujdes mundësinë më të mirë.

### AKREPI

Keni të bëni me çështje të brendshme dhe familjare të pazgjidhura, dhe mund ta shfaqni më shumë sesa duhet nervozizmin. Përpigjuni ndërsa që jeni i mirëkuptueshëm. Mund të gjeni gjithmonë një pikë të përbashkët dhe të arrini kështu në një kompromis për të kënaqur gjithkënd.

### SHIGJETARI

Ata që varen nga ju nuk bëjnë punën e tyre ashtu siç prisni, qortojni sigurisht, por pa e bërë të madhe. Nuk keni arsye perse ta bëni. Më mirë thojni gjërat siç janë, pa shumë lojë fjalësh, në mënyrë të qartë, të drejtpërdrejtë dhe të saktë.

### BRICJAPI

Nëse në të kaluarën keni marrë një ndihmë të papritur, tani është koha ta ktheni favorin pa u tërhequr mbrapsht. Në fund edhe ju do të shpërbleheni. E rëndësishme është t'ia nisni mbarë. Nganjëherë gatishmëria vlen, në disa raste, më shumë se çdo gjë tjetër.

### UJORI

Nëse po shqyrtoni mundësinë për një udhëtim, për argëtim apo për punë, mos u ktheni mbrapa. Parashikohen përvoja shumë interesante në vijim! Mund të pasuroni bagazhin tuaj kulturor me njohje dhe njohuri të reja. Me të vërtetë shumë mirë.

### PESHQIT

Mos u hidhni shumë përpjetë, nëse nuk doni të rrezikoni të rrëzoheni! Duhet të qëndroni me këmbë në tokë dhe të mos përfshihen nga aventura tepër të rrezikshme. Mendoni për pasojat e veprimeve që kryeni, do të shmangni rrezikun për ta pësuar.



# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 585

SUPLEMENT I PERJAVSHEM

GAZETA SHQIPTARE


Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 18 Nëntor 2017

## REGJISORI SPEKTAKLI



ZIHET ME TE GJITHE AKTORET,  
ALTIN BASHA LARGOHET  
NGA "PORTOKALLI"?



FESTIVALI I RTSH, KRASTA E  
KUKË: GARANCIA JEMI NE, NUK  
NA INTERESON ÇMIMI I PARE

# ALKETA VEJSIU

"BRAKTIS"  
TV 'KLAN'?  
FLET  
MODERATORJA:  
JA SI QENDRON  
E VERTETA

INTERVISTA



*"Ju rrëfej çfarë  
më lidh me  
Paolo Bonolis"*

# ROZA LATI



*"Mua nuk më plas fare për  
kommentet e njerëzve, jam mësuar me to"*

**"Ja kush  
është  
'pronari' në  
jetën time"**

Zihet me të gjithë aktorët,

## Altin Basha

largohet nga "Portokalli"?

Është vënë në qendër të mediave dhe rrjeteve sociale për shkak se u akuzua nga shumë aktorë si shkak kryesor i largimit të tyre nga show humoristik, "Portokalli", të paktën të shumicës prej tyre. Këtë vit, regjisori i "Portokallisë" Altin Basha, ka fituar çmimin si "regjisor i vitit" për shfaqjen "Made in Albania" në ndarjen e çmimeve "Kult". Pas marrjes së çmimit ai është shprehur se ka ndërmend që t'i rikthehet sërisht teatrit. "Për momentin, jam pak i zënë ngushtë, sepse jetoj mes dy botëve. Televizioni më merr kohën më të madhe tani për tani, por besoj se ka ardhur koha t'i rikthehem dashurisë time më të madhe, teatrit"- ka thënë ai.

Ende nuk dihet, nga këto fjalë të tij nëse ka ndërmend që ta lërë "Portokalli"-në e të nisë një sfidë të re, por fjalët lënë vend për dyshime.



# Festivali i RTSH, Krasta e Kuke: Garancia jemi ne, nuk na intereson çmimi i parë

22 këngë në garë, "mendojeni sikur do vini në Ariston, ka këngë shumë të bukura"

Fatmira Nikolli

Në të tre s'do të ishim këtu nëse nuk do të kishim një festival që jep garanci. Sa për deklaratat e ndryshme, ne nuk i marrim në konsideratë dhe nuk u kthejmë përgjigje. Do u kthejmë përgjigje në festival dhe do t'i bëjmë t'u shkojnë djersët. Siç thuhet, ata që vijin në nderojnë, ata që nuk vijin, na bëjnë nder". Kështu u shpreh Adi Krasta dje, i pyetur nga "Gazeta Shqiptare" mbi deklaratat e këngëtarëve mbi Festivalin e RTSH-së. I ulur përkrah regjisorit Pali Kuke e drejtuesit muzikor Sokol Marsi, treshja prezantoi në një konferencë për mediat në pika të përgjithshme Festivalin e 56-të që do të ketë 22 këngëtarë, nga 11 në dy net. I pyetur për deklaratën e Kastro Zisos, Sokol Marsi shtoi se nuk ka asgjë të vërtetë në çfarë thuhet. Në komision kanë qenë pesë anëtarë që kanë votuar sipas mendimit të tyre. Për detaje të tjera ju mund t'i drejtoheni zyrës juridike, shtoi ai. Marsi, e vuri theksin te fakti që të gjithë janë aty që të garantojnë një festival të ndershëm dhe të bukur. Sokol Marsi tha se ka qenë skeptik kur iu dha detyra, por, kur mësoi se do punonte me Pali Kuken e Adi Krastën, që i cilësoi njerëzit më të rëndësishëm në median shqiptare, tha se mori siguri. "Jam i lumtur që shoh Manjola Nallbanin, Elton



Dedën, Orgesa Zaimin, Mari-za Ikonomin. Jam i lumtur që ka këngëtarë 'big' dhe emra të rinj. Mendoj se do bëjmë festivalin tonë", -tha ai. Marsi shtoi njëherësh se Këshilli i RTSH ka miratuar një rregullore që do të nënshkruhet nga të gjithë dhe se këngët do dalin në youtube dhe në mediat sociale si dhe do bëhet një version video për emisionet e RTSH në mënyrë që publiku të njihet me këngët para nisjes së festivalit.

### MBIJTESA MË 1972 E 1997

Regjisori Pali Kuke premtoi surpriza duke e vënë theksin te Adi Krasta, si garancia e suksesit të festivalit. "Festi-

vali është institucion që ka grafikën e vet me ulje e ngritje. Është fat që e duan të gjithë dhe reziston. Duroi gjithë atë ndërkryerje dhe nuk u tremb më 1972. Duroi edhe vitin 1997 madje guxoi të mos ndërpritej. Sivjet do ngrihet më lart se ka shumë interes. Duke mbrojtur vlerat e Festivalit do bëjmë një show të madh", -tha Kuke. Duke vlerësuar cilësinë e këngëve pjesë-marrëse ai tha se ka më shumë se 5 këngë që do mbeten nga ky festival. I pyetur se ç'risi ka sivjet ai citoi një emër të madh. "Patën pyet Tish Dainë- ç'a të reje ka- ai tha janë: jana fana kangt e reja more".

### KRASTA 'SHOW'

Edhe në bisedat para konferencës Adi Krasta vinte në dukje të shijuarit e festivalit më shumë se çdo gjë tjetër. "Ne qeshëm me njëri-tjetrin kur vendosëm ta bënim. Të shkonim kundër rrymës së viteve. Pali tha "ringritje" është term. Ne nuk bëjmë dot "Sanremo", por duam që çdo sekondë ta ndojmë ndryshe jo vetëm nga kolegët që e kanë bërë ndryshe. Për mua mund të jetë festivali i fundit. Kemi vendosur të kënaqemi. Festivali është sober. Jo me gjëra të tepruara. Se çdo gjej për të folur Zotë e di", -tha ai mes shakasë dhe seriozitetit. Kam qenë i entuziazmuar me

skenën, shtoi, duke treguar imazhin pas shpinës së tij. "Largohemi nga skena pllakateske dhe futemi në skenë të mbuluar. Prezantuesi është i varfër kur nuk ka kontakt me artistët" - tha Krasta. Pati një thirrje për këngëtarët: "Ejani në këtë festival sikur po shkoni në Ariston si nga veshja dhe nga paraqitja. Do ketë këngë të bukura. Ne nuk jemi fare të shqetësuar kush fiton çmimin e parë. Është me interes zero. S'më kuriozon fare kush shkon në "Eurovizion". Ne nuk do merremi me kush u kualifikua e kush jo. Ne si organizatorë kemi marrë vendim të kënaqemi shumë."

### POSTFESTIVAL

Këtë vit diskutimet do të bëhen në një postfestival. Krasta tha se do të bëhet një postfestival në skenë në tri net ku prania e artistëve është e detyrueshme. "Jemi ndjerë të futur në rrjedhë thashethemnajash e në një vorbull fjalësh. Do jemi aty në postfestival për këngët e do të flasim për tema të mëdha. Biseda do prekë tema të forta që nga rënia e sensit të humanizmit në këtë vend e deri te biseda për ata që e duan këtë vend dhe rinë këtu e më pas do përballemi me veten. Të kuptohemi, postfestivali është analitik, por jo prashitje në bahçe. Është e folur me analizë dhe me mendim të pjekur, do kemi vlerësimin e gjykimin tonë", -tha Krasta.

DREJTUESJA E "DANCE WITH ME": JU RRËFEJ ÇFARË ME LIDH ME PAOLO BONOLIS

# ALKETA VEJSIU

## "braktis" TV 'Klan'? Flet moderatorja: Ja si qëndron e vërteta

*"Ju tregoj për emisionin 'surprizë' që do të nisë së shpejti, me protagonistë fëmijët"*

loj një spektakel të ri në Klan. Kam pasur gjithmonë një qasje për të bërë diçka edhe përtej kufijve dhe jam në rrugë të mirë. Vetëm kaq mund të them tani.

**-Po për spektaklin në Klan mund të më thoni diçka më tepër?**

Do bëj atë që bën Paolo Bonolis. Ai është stili i prezantuesit që pëlqej. Me humor, me batuta, me përmbajtje. Po kërkojmë fëmijë që s'kanë asnjë pengesë në komunikim publik, që dinë të bëjnë pyetje, që ngacmojnë personazhet VIP që do jenë nga çdo fushë politike dhe art.

**-Si emisioni "Avanti un altro"?**

Jo, "Peter Pan".

**-Ju do jeni në krah të tij si përfundim apo është thjesht një zhurmë e mediave? Do jeni edhe në Klan edhe në Mediaset?**

Për momentin jam në Tiranë, në Klan, me impenjimet e mia të zakonshme. S'e përjashtoj mundësinë që të bëj diçka më të mirë, më të madhe për Shqipërinë dhe për veten në Itali.

**Emisioni surprizë që do të startojë së shpejti në TvKlan:** "Kush e futi në kurth Peter Panin"

Vjen nga origjinali "Chi ha incastrato Peter Pan" ku moderator për 7 puntata radhazi është figura e njohur e televizionit italian, Paolo Bonolis. Një emision i tillë ka në qendër të vëmendjes dhe protagonistë të programit janë fëmijët nga mosha 4 deri në 9 vjeç, të prezantuar në çdo seri në grupe me rreth dhjetë veta; fëmijët në studio, sidomos në edicionet e para, iu nënshtroheshin pyetjeve mbi argumente që i përkasin botës së të rriturve, ose merreshin për të komentuar fakte të aktualitetit apo sportit. Gjatë transmetimit ndërhyjnë edhe disa kategori personash, si për shembull: zjarrfikësit apo policët, të cilët u shpjegojnë fëmijëve punën që ata bëjnë dhe u mësojnë se si të sillen në rast emergjence, ose si t'i evitosh ato. Dy janë pjesët kryesore dhe thelbësore të programit: E para janë kamerat e fshehta, në të cilat fëmijët janë "viktima" të shakave të krijuara nga regjisorit, si për shembull: të mbash një akullorë në dorë pa e lëpirë gjatë mungesës në dhomë të moderatorit të emisionit; ndërkohë që pjesa e dytë, ajo më kryesorja, janë intervistat me të tarrat VIP, gjatë të cilave fëmijët pyesin personazhet e spektaklit, të televizionit, të muzikës apo të sportit, për kuriozitetet që duan të dinë.

Ky mund të jetë edhe një nga shkaqet e udhëtimeve të shpeshta të bukurshes së TvKlan në shtetin fqinjë. Një tjetër emision i suksesshëm do t'i shtohet ekranëve shqiptare, dhe protagonistë do të jenë ata që i japin më tepër esencë ekranit, fëmijët.



Pamela Aliaj

**D**itët e fundit në media është përfolur shpesh se moderatorja e njohur e TvKlan, Alketa Vejsiu do të "braktisë" televizionin e saj të dashur ku tashmë është bërë prej vitesh pjesë e pandarë e tij për të nisur një tjetër aventura televizive në shtetin fqinjë. Sipas zhurmës së krijuar thuhet se ikona e TvKlan do të fillojë një tjetër sfidë përkrah moderatorit të njohur italian, Paolo Bonolis në një nga mediat më të mëdha në Itali, Mediaset. Por në një prononcim ekskluzivisht për "Bluetooh" të "Gazeta Shqiptare", Alketa ka përgënjeshtuar këto zëra. Ajo ka thënë se një gjë e tillë është thjesht një hamendësim i mediave. Gjithashtu, ajo ka shtuar se nuk ka ndërmend për momentin të largohet nga TvKlan dhe për më tepër ka nisur provat për një emision të ri me fëmijë, i frymëzuar nga emisioni i suksesshëm italian. Për me tepër intervista më poshtë.

**- Është përfolur në media se do të filloni një projekt të ri në Itali në krah të Paolo Bonolis. Për çfarë bëhet fjalë më konkretisht?**

Ka pasur shumë tituj online të hamendesuar këto kohë! Fil-



Flet moderatorja: S'ka femra të shëmtuara sot, ka thjesht femra dembele

Prëfeket

# ROZA LATI:

## Ja kush është 'pronari' në jetën time

*"Mua nuk më plas fare për komentet e njerëzve, jam mësuar me to"*



Pamela Aliaj

Ajo është parë shpesh në ekranet televizive në formate të ndryshme të show-bizit me një stil ndryshe e tepër të veçantë. Pas një shkëputje të shkurtër, bukuroshja Roza Lati, rikthehet sërish në një tjetër format interesant. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" Roza folur për prapaskenat e emisionit më të ri në Ora News, "Why Not". Duke iu përshtatur dhe natyrës e stilit të saj tepër unik, emisioni vjen me nota humorit e me të papritura nga të ftuar "surprizë". Gjithashtu,

ajo ka folur edhe për projektet e saj për një linjë të brendshmesh ku është shfaqur shumë seksi në fotot e postuara në "Instagram". Një "Why Not" për guximin e saj dhe për mbështetjen që i jep femrave single që ia dalin vetë në jetë, si Roza. Por nuk kanë munguar as detaje nga jeta private. Për më tepër në intervistën më poshtë.

**-Për herë të parë pas një shkëputje nga tv ju shohim në një tjetër format. Si lindi ideja e tij? Çfarë surprizash rezervon puntata e dytë?**

Nuk jam shkëputur asnjëherë nga TV. Kam pasur

paузën e sezonit derisa mora sezonin e ri. Ndërkohë për këtë projekt, e kam pasur në plan që kur kam qenë në Agon Channel. Thjesht duhej të isha në pozicionin e duhur për të lëvizur gurët e duhur. Puntata e radhës rezervon humor dhe të qeshura pafund!

**-Cili është i ftuari më special që do të doje të kishe në emision? Cila do të ishte pyetja më pikante që do t'i bëje?**

Nëse të tregoj kush do ishte, atëherë s'ia vlen ta ftoj kurrë.(qesh)

**- Rozën e shohim në një tjetër projekt. Në një set fotografik shfaqesh super-**



**seksi. Për çfarë bëhet fjalë? Do të të shohim në një projekt më të madh? Si nisi gjithçka?**

Fotografitë kanë qenë gjithmonë pasion i imi. Madje kështu e kam nisur rrugëtimin tim në art. Në fillim me foto. Duke bashkëpunuar me Niko Komanin, për revistën Anabel. Dhe jo vetëm... Fundja për sa kohë ndihem mirë fizikisht... Why Not???

**-Ke lidhur kontratë me ndonjë firmë të njohur të brendshmesh?**

Kam bërë bashkëpunim me një pagesë goxha të mirë! Bashkëpunime sezonale. Jo kontrata të mirëfillta.

**-Me çfarë merret Roza në kohën e lirë përveçse me dashurinë e madhe tuajën, qentë?**

Jo vetëm qentë, kafshët, të gjitha gjallesat. Koha ime e lirë, është gjumë. Kam shumë nevojë për gjumë se djeg shumë motor gjatë ditës. (qesh)

**-A ke në plan të hapësh një "animal shelter" meqë je animal lover?**

Jam interesuar vërtetë për këtë gjë, por këto angazhime duan kohën e vetë fizike... dhe unë nuk e kam. Jam interesuar seriozisht, por më thanë që ka shumë ligje dhe angari nëse dua ta bëj ashtu siç duhet, me kushte të mirëfillta perëndimore.

**-Ke një marrëdhënie shumë të veçantë me mamin. Si është të jesh fëmijë i vetëm me një single mami?**

Nga e di ti që mami im është single? (Qesh) Ajo është e lumtur. Dhe kur ajo është e lumtur, jam edhe unë.

**Në një video të publikuar më parë me një fëmijë të vogël thoshe që doje të kishe një vajzë me emrin Perla. Po djalit si do t'ia vije emrin?**

Mmmm... Djalit do të doja t'ia vija Kristal. Me theksin te i-ja. Sepse im atë e ka pasur Kristo. Dhe...si Perla dhe Kristal, janë materiale të pastra, ndër më të mirat në botë.

**-Ndonjë plan së shpejti për fëmijë? Çfarë mendimi ke për mamatë single? A do ta rriste Roza fëmijën pa figurën e të atit?**

Plan së shpejti për fëmijë??? (Qesh) U bëftë më e mira për mua, por s'kam plan tani... Për femrat nëna single kam respekt maksimal sepse, nëse një nënë me babain e fëmijës e ka një shpatull ku mbështetet, nëna single e ka shumë më të vështirë. Kështu që kam këtë mesazh për to: Ngre një doli për femrat e forta, shpresojmë t'i njohim ato, shpresojmë të jemi si ato! Shpresojmë t'i rrisim vajzat tona si ato!



**-Si reagon Roza ndaj të gjithë atyre që "flasin keq" apo komentojnë keq për çdo sukses tuajin?**

Po të mos më komentoni keq do të thotë që s'kam arritur asgjë në jetë. Urrejnë atë që bën sukses. Urrejnë atë që arriti atë gjë që s'po e arrijnë dot vetë ata. Troç, mua nuk më plas fare për komentet e njerëzve. Jam vajza e artistes, jam mësuar me këto komente dhe thash-etheme qëkur fillova të kuptoj gjuhën shqipe.

**-Pse gjithnjë e përsërit faktin që je "selfmade"? Ç'mendim ke për gocat që kanë një të dashur (tullac) me lekë?**

Nuk i gjykoj keq. Por për sa i përket tipit tullac me lekë: jam unë tullaci me lekë në jetën time. Nëse kam një pronar, jam unë pronari i vetes time. Nuk nënshtrohem dot me lekë. Dhe nuk mund t'i rri afër dikujt prej lekëve. Unë eci me ndjenjë. Qartë.

**-Të shumta janë "të famshmet" apo modelet e "Instagramit" që po "uzurpojnë" ekranet. Si mendon Roza: audienca tërhiqet më tepër nga pamja apo nga brumi?**

Të dyja bashkë. Nëse ke fat, atëherë i ke të dyja! Pamja shet në ekran. Sepse publiku të SHEH. Dhe ti duhet të nxjerrësh në pah më të mirën e vetes tënde. Pastaj varet sa e aftë je ta mbash të mbërthyer publikun përpara ekranit për më shumë se 3 minuta. Unë kam investuar shumë te të dyja.

**-Është bërë si trend ku pjesa me e madhe e vajzave bën ndërhyrjet kirurgjikale në fytyrë e trup. Do të bëje një tjetër ndërhyrje veç asaj që ke bërë? A je penduar?**

Mos po ngatërron personazh me këtë pyetje? Se dallimi im është që unë nuk jam ekzagjeruar. Mendoj një fije e hollë e ndan të bukurën nga ekzagjerimi. Për mua s'ka femra të shëmtuara sot, ka thjesht femra dembele.

**-A është dikush i rëndësishëm në jetën e Rozës?**

Ekziston një i rëndësishëm, por meqë qenka kaq i rëndësishëm, dua ta mbaj për vete.

**WHY? NOT**

nga **Roza Lali**

E Shtunë  
Ora 22:30




www.oranews.tv



## Befason aktorja e "Dance with me": Së shpejti dasmë

Ajo padyshim është një nga aktoret simpatike më të reja të humorit, e cila dallohet për originalitetin dhe karakterin e saj të hedhur. Ana Lika, një nga konkurrente në "Dance with me", ka treguar se misioni i saj aty ishte të gjente një burrë. Ndërkohë që në puntatat e tjera, aktorja tha se thirrja që bëri në fillim të spektaklit kishte qenë vetëm diçka për të qeshur, sepse në të vërtetë ajo e kishte dikë në krah. Ndërsa sot mesa duket ajo ka treguar tjetër gjë. Gjatë provave për spektaklin e së shpejti, Anais ka publikuar një video ku shfaqet duke kërcyer me aktoren tjetër të humorit, Rudina Dembacaj dhe ka shkruar: "Rudina po përgatitet për dasmën time, se si do kërcëjë e çfarë do të thotë kur të vij në krahujt". Sërisht një nga shakatë e radhës të aktore është kjo apo presim vërtet një dasmë së shpejti?



## Ministria e Financave: Përfituesit të dorëzojnë numrin e llogarisë bankare

# Ish-të përndjekurit, 1200 përfituesit e rinj të këstit të dytë

## Trashëgimtarët të dorëzojnë dokumentin brenda muajit

Ornela Manjani

**M**inistria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që do të marrin dëmshpërblimin brenda muajit. Janë rreth 1200 përfitues, të cilët duhet të dorëzojnë numrin e llogarisë bankare brenda nëntorit për të marrë këstin e dytë të dëmshpërblimit.

### DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumata e dëmshpërblimit kthehet

mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, emër/mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një shkronjë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile.

Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e

gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

### Nr dosje Vkm Emer Atesi Mbiemer

112 509 Hasije Musli Kera  
112 509 Enkelejda VehbiMusaj(hasa)  
117 509 Xhelal Veli Celhema  
143 509 Sheqere IsufBejtja  
144 509 Lule Prek Lushi(ujka)  
211 509 Minire Shyqyri Beqo  
218 509 Behije BelulMullaliu  
226 509 Lazem Zabitsufaj  
241 268-479 Makbule Sino Braho  
243 509 FatimeEkuranMaliqllari  
243 509 Nezir EkuranPeshkepia  
243 509 Aristo Sabri Peshkepia  
243 509 Valbona SabriMyftaraj  
243 509 Fatrit Sabri Poeshekepia  
243 509 AlmaSabri Hoxha  
272 1015 Llambro Petro(kokali)loli  
281 509 Ildishane Izet Doci  
281 509 Myzejezenzet Mehmeti  
283 509 Abdyl Osman Balla  
296 186 Bam Kashari Sali  
334 509 Munir Ali Bana  
338 509 Spiro Jani Shuteriqi  
365 509 NikollaJorgji Vidheli  
388 509 Kristina Demo Rapaj  
393 509 Shaban Hasan Hoti  
393 509 Lutfije Hasan Kelmendi  
503 509 Skender Xhetan Toçi  
588 509 Lutfi Hashim Pira  
662 497 Shamet Tare Cocka  
662 497 Astrit Tare Cocka  
662 497 MemetTare Cocka  
666 509 Kosta PaguniDani  
667 509 VasilloJani Miciniko  
853 509 Shpresa Dhimitri Jano  
870 509 Mete Ferik Zenunaj  
870 509 Bylykbash Ferik Ebeja  
870 509 MyslyFerik Ebeja  
896 509 Ilir HysenHyseni  
914 509 Sanije Murat Kodra  
922 509 Sabrije Mahmut Markja (tola)  
1029 509 ReshimkoGani Kishta  
1029 509 Rushit Gani Kryemadhi  
1029 509 Qamile Gani Mimih  
1029 509 Azbije Selman Mehalla  
1029 509 Xhevit Selman Kryemadhi  
1029 509 HavaSelman Kotorri  
1029 509 Bajram Selman Kryemadhi  
1029 509 Lavdije Selman Dollani  
1029 509 Lumturije Selman Tocila

1070 509 Gezim Ymer Deliu  
1111 382 Katrine DodeKocek  
1224 509 Ismail Riza Hoxha  
1234 509 Gjeto Gjon Macaj  
1395 509 Mara Mark Gjura  
1395 509 Bardhok Zef Gjura  
1439 509 Hamit Xhafer Pana  
1477 509 Ndoc Ndrej Culaj  
1588 509 Qefsere Tasim Vladi  
1588 509 Luftetar Nadirkamsi  
1597 509 Gezim Muharrem Daka  
1654 509 Gjergj Ndue Gega  
1669 509 Resmije Neki Lenja  
1669 509 Naxhije Neki Kurteshi  
1669 509 Altin Meleq Shahu  
1707 509 Mihane Ali Gashi  
1707 509 Ram Mehmet Rogani  
1743 509 Dhimitraq FotiPetro  
1755 509 Prenda Zef Ndoj  
1859 509 Zef Pjeter Xhaja  
1874 509 Neshet Kamber Rruli  
1874 509 Mejmene Astrit Kembora  
1874 509 Renata AstiritRruli  
1874 509 Kamber Sedat Rruli  
1874 509 Kastriot Sedat Rruli  
1874 509 LiljanaSedat Celsula  
1874 509 Virgjil Kamber Rruli  
1874 509 Xhevdet Besim Ruli  
1874 509 ArturBesim Ruli  
1874 509 AjkondaBesim Gina  
1874 509 Seavete Kamber Maci  
1893 509 Vehbi BajramBushaj  
1910 509 MarkPjeter Hoti  
1970 509 Arben IbrahimHima  
1986 509 Vangjel TheodorCoka  
1986 509 Sotir Theodor Coka  
1986 509 Geraldina Theodor Mihali  
1986 509 Arben Aleksander Coka  
1986 509 Romeo Petra Rama  
1992 509 Vangjel Foto Papakristo  
1992 509 Janulla Foto Papakristo  
1996 509 Ali Hamit Damzi  
2007 509 Clirim Islam Lenja  
2007 509 Dhurata Islam Lenja  
2007 509 Matilda Islam Lenja  
2029 509 Haki Said (sait) Bushaj  
2034 509 Baki Latif Nezha  
2080 509 EleniJani Gumeni  
2093 509 Abdulla Sadik Koka  
2093 509 Xhevahir SadikKoka  
2093 509 Rexhep Sadik Koka

2093 509 Ylmije Sadik Kurthysa  
2106 509 Fran Ndrej Gjonaj  
2106 509 Gjergj Gjet Gjonaj  
2118 509 Shefqet Islam Dobra  
2168 509 RobertThomai Petro  
2171 509 Lush Fran Filipi  
2223 509 Kujtim Hasan Lazaj  
2233 509 Gjet KolLeka  
2235 509 Andoneta Leandro Nuredini (terpo)  
2235 509 LilianaLeandro Kaci(terpo)  
2235 509 Raimonda Thanas Nica (kosta)  
2235 509 Enela Thanas Lango(kosta)  
2327 1699 Lemo Qano Kokaj  
2338 509 Zef Preng Lleshi  
2338 509 Dave Dod Ahmetsulaj  
2338 509 Bardhe Dod Salaj  
2338 509 Viktor Dod Lleshi  
2338 509 Aleksander DodLleshi  
2338 509 Vojsava Dod Ndrejalaj  
2338 509 Bardhok Dod Lleshaj  
2338 509 LuanPalLleshaj  
2338 509 Shpresa Pal Kokaj  
2338 509 Bukurie Pal Cakoni  
2340 509 Daut Idriz Cekaj  
2360 509 Prenna Mark Ramaj  
2360 509 Dila Gjin Pjetri  
2360 509 Zef Gjin Marku  
2468 509 Sejfulla Nexmedin Nenaj  
2541 509 LuanLaver Selmanaj  
2541 509 Gerardina Tefik Spahiu  
2541 509 Lavdije Namik Zeqo  
2541 509 ThomaReshat Prifti  
2552 135 Shefqet Jakup Dedej  
2592 509 Xhemile Sulejman Potja  
2600 509 Perikli Jani Jorgji  
2682 509 Mustafa Hazis Pira  
2682 509 Aqif Hazis Pira  
2682 509 Pellumb Xhavit Sina  
2682 509 Mukades Xhavit (qerimi)  
2682 509 Shqipe Skender Datja  
2682 509 Zija Skender Pira  
2682 509 Shqip Skender Pira  
2684 509 Rrok Nikoll Ndoci  
2768 509 Din Islam Nokshiqi  
2805 497 Rystem KadriMuzhaqi  
2805 497 Ismete Kadri Cekani  
2805 497 Mitat Kadri Muzhaqi  
2805 497 Haxhi Ismail Kondraxhiu  
2805 497 Teuta Ismail Murati

2805 497 Elizabeta Ismail Huda  
2805 497 Dilaver Ismail Kondraxhiu  
2805 497 Voisava Ismail Kondraxhiu  
2805 497 Majlinda Ismail Kondraxhiu  
2843 497 Tefta Hamza Mucaj  
2843 497 Donika Hamza Rrapaj  
2874 509 Nazif Isa Zeqiraj  
2874 509 Izet Isa Zeqiraj  
2874 509 Adil (hadil) Isa Zeqiraj  
2874 509 Rronje Isa Zeqiraj (alibeaj)  
2874 509 Kadri Isa Zeqiraj  
3066 509 Mrij Nikoll Gjeca(ivanaj)  
3121 509 Kadri Dine Thaci  
3132 509 Eduard Tefik Dashi  
3174 509 Dava `ded Pjetri  
3187 509 Sabrije RamadanPira  
3187 509 Sabri OsmanPira  
3231 509 Erfan Jace Rapo (rrapo)  
3231 509 Xhemile Islam Rapo  
3291 497 Drita(e) Bajram Mulaj  
3336 509 Gjesh Tone Biku  
3405 509 VullnetFaik Bushaj  
3573 509 Palok Luc Delaj  
3573 509 Shaqec Luc Purashaj  
3573 509 Tone Luc Vulaj  
3573 509 Gjeste Nikoll Ulaj  
3573 509 Flora Nikoll Durgaj  
3573 509 Prel Nikoll Delaj  
3573 509 Drane Martin Smakaj  
3573 509 LuceMartin Dreshaj  
3573 509 Rita Martin Camaj  
3669 509 Mehdi Halit Rustja  
3671 509 Bardhyl Riza Xhakolli  
3685 509 Nimet Hasan Ballii  
3701 509 Asie Muharrem Guri  
3705 509 LinditaPalMarku  
3734 509 Kadife Abdi Hoxha  
3734 509 AlltaneAbdi Hoxha  
3734 509 Arshi Abdi Ndrej  
3751 509 GjeleLala Preng  
3768 509 Zoica Foto Nini  
3796 509 Mujo Gani Hoxha  
3796 509 Muhamet Hamdi Hoxha  
3796 509 Eugen Hamdi Hoxha  
3807 509 Muharrem Metush Cekaj  
3807 509 Kujtim Hasim Cekaj  
3807 509 Bujar Hasim Cekaj  
3807 509 Nexhmije Hasim Bushaj  
3863 509 Gjok Luc Dacaj  
3918 509 MarkSadri Bregu  
3918 509 Zef Sadri Bregu










**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Pupi regjisor.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
- Turner aktore.
- Fillojnë festat.
- Skuadër greke.
- Falen pa fe.
- U shkrua nga Gorkij.
- Një sferë për... model.
- Janë bisha.
- Parashtesë për dy.
- Demoni që persekutonte Sarën.
- Stacion i famshëm orbital.
- Mendes regjisor.
- Një rreth i ngushtë miqësor
- Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
- Këndohen në opera.
- Është lajm i vjetër.
- Sharif aktor.
- Martin i Norma Rae.
- Mund të jenë filmi.

**VERTIKAL**

- Morissette këngëtare.
- Kilmer aktor.
- Heche aktore.
- Fillojnë tatëpjetën
- Është diapozitiv shumë i ndjeshëm.
- Mbyllin spitale.
- Në krye të masave.
- Bëjnë shirit me shi.
- Qe vajza e Tantalit.
- Janë më shumë se dëshira
- Ishte dekret i sulltanit.
- Qe mbret i urtë i Pilos.
- Quinn aktor.
- Gasol i NBA.
- Fillojnë garën.
- Një pjesë e reformave.
- Është si biskotë.
- Mund të jetë karmelitan.
- Sjellin shi.
- Bel i Maupassant.
- Direk pa ekstreme.
- Gjysma e bimëve.
- Mbyllin një motor.
- Është bitum.
- Fara këngëtare.
- Hanks aktor
- Stiller aktor.
- Morrison rockstar.
- Fillojnë masat.
- Në krye të tabelës.
- Derisa janë në fund.
- Fund filmi.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Film i hitchcock.
- Fillojnë premierën.
- Janë legjendat.
- Kush ka... ka zëft.
- Thurman aktore.
- Një pjesë e testamentit
- Një pjesë e studimeve.
- Kështu është situata e tensionuar.
- Telefoni në kartvizitë.
- Është ngasje.
- Në krye të autoriteteve.
- Mbyllin mbledhjen.
- Nisin nga kreu.
- Fillojnë aafirmim.
- Cocker këngëtar.
- Bartok kompozitor.
- Tiriac që qe tenist.
- Oxa këngëtare.
- Kalimi në ekstreme.

**VERTIKAL**


- Janë enigmatikë.
- Emri i Vivaldit.
- Rjedh në klepsidër.
- Inicialet e Selleck aktor.
- Fillojnë rubrikën.
- Ishte babai i Proknt dhe Filomelës.
- Vitet pa kufij.
- Mbyllin kanate.
- U shit për një pjatë thjerza.
- ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
- Moore aktore.
- Rocca aktore.
- Janë përmasa.
- Fund dhjetori.
- Mbyllin krahun.
- Fillojnë kalimin.
- Duhën ruajtur.
- Ishte Europa komuniste.
- Agjenci Kombëtare Lokale
- Berg kompozitor.
- Të parat në Amsterdam.
- Elsa këngëtare.
- Memoria në computer
- Me të nxjerrin trarë.
- Në mes të dhomës.
- Ekstreme kateti.
- Kufijtë e lutjes.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

2		3	8			4		9
			4	6	5	3	7	
	6		2					3
	9		7					6
7		5				1		8
3					2		5	
5					8		7	
		2	3	1	7	8		
1	8				9	6		4

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	9	6	4	8	5	3	7	1
7	5	3	1	2	6	8	4	9
8	1	4	9	3	7	6	2	5
6	3	5	7	4	9	2	1	8
9	7	2	8	5	1	4	6	3
1	4	8	3	6	2	5	9	7
4	8	7	6	9	3	1	5	2
5	6	9	2	1	8	7	3	4
3	2	1	5	7	4	9	8	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Të lëndosh të pamerituarën, është një satirë therëse. (Benxhamin Franklin)
- Duartrokjia është nxitje për njerëzit fisnikë, dhe fundi i qëllimit për të dobët. (Carls Kaleb Kolton)
- Besimi ynë më i madh është për gjërat rreth të cilave dimë më pak. Dhe përderisa në dimë më pak për veten, jemi gati të besojmë gjithçka që thuhet për ne. Largojuuni fuqisë misterioze si të mburjes ashtu dhe të shpifjes. (Erik Hofer)

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	11	18	3	10	18	2	1	15	20
3	2	6	5	3	2	1	5	1	13	1
21		4	3	5	6	2	1	5	5	10
1		6	10	1	2	8	11	6	4	1
2	13	7		2	1	5	1		1	2
	19	1	7	3	5	6		15	14	10
13	3	5	5	2		5	6	11	1	1
5	2				21		19	6	2	1
1	5	7		6	2	8	5	10	8	6
16	8	7	8	17	6	5		1	6	21
6			15	8	5	1	5		18	3
4	3	18	8	7	6		18	6	4	6

S	U	P	A	I	K	K	U	R	S	I
A	P	E	R	A	T	U	R	A	H	K
T	T	O	P	A	T	P	A	P	A	S
K	E	M	A	L	T	A	K	A	I	
P	A	R	E	T	I	T	R	U	R	I
R	P	I	A	M	E	L	I	A	S	
E	T	A	T	A	E	T	L	S	H	
P	O	N	Y	E	R	I	I	U	T	
I	L	T	Y	M	I	E	M	K	E	
T	I	R	A	N	E	T	R	I	M	A
E	N	T	I	T	A	N	I	K	E	E
T	A	U	E	T	K	U	R	A	T	

*Thënie të mençura*

- Ekspierencia është emri që çdokush i vë gabimeve të tij. (Oscar Wilde)
- S'ka gjë më të tmerrshme se sa të shikosh injorancën në veprim. Johann Wolfgang Goethe Shkrimtar (1749-1832)
- Bota është plot dyer, plot raste, fije të tendosura që presin t'u biesh. (Ralf Valdo Emerson)
- Të jesh gjithmonë i ndershëm me veten, është një ushtrim i këndshëm. (Sigmund Frojd)

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

A	R	M	A	N	D	L	I	N	D	A
V	E	A	J	I	E	M	V	E	K	L
A	D	E	N	L	A	K	E	O	A	Z
T	A	K	M	I	L	I	T	A	N	T
R	A	F	I	N	E	R	I	T	E	L
F	E	A	N	A	T	I	K	E	T	H
D	E	N	A	R	A	E	G	E	G	
E	A	J	E	H	E	R	O	N	J	
M	A	R	I	A	N	A	P	I	N	E
E	T	E	R	E	T	I	K	E	T	A
K	A	T	A	R	A	K	T	I	A	T

**FJALËKRYQI (2)**

A	D	A	M	I	R	E	F	O	R	M	A	T
R	E	K	O	R	D	M	E	N	E	L	A	U
S	R	I	P	E	K	I	N	M				
E	R	O	S	K	A	N	O	T	A	Z	H	I
N	I	R	P	O	L	E	M	I	K	A	T	I
E	C	P	E	R	I	M	E	T	E	R	M	
K	R	I	J	I	M	N	A	T	I	E		
E	T	K	M	T	I	N	G	R	I	D		
M	A	T	E	R	A	L	I	L	I	G	U	
T	N	A	T	R	U	M	O	A	Z			
L	E	G	J	E	N	I	U					
E	T	E	A	L	T	A	R	E	T	I	T	

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

